



Mandati i ri, mundësi të reja

Vlerësim i punës së Kuvendit të Kosovës
me rekomandime për zhvillim të mëtejshëm

Bashkë-financuar nga:



Prishtinë,
Tetor 2008

Mendimet e shprehura në këtë tekst i përkasin autorit - Milan Martin Cvikl dhe nuk paraqesin doemos mendimet e institucioneve që e kanë financuar hulumtimin apo institucioneve në të cilin është i punësuar autori. Hulumtimi për këtë raport është organizuar nga Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) dhe është bashkë-financuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Ky raport është mundësuar nga përkrahja e popullit amerikan përmes Agjensionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) Mendimet e shprehura në këtë tekst i përkasin autorit dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

PËRMBAJTJA

1. MIRËNJOHJE	5
2. VIZIONI I KUVENDIT TË KOSOVËS PËR VITET 2011, 2014 DHE 2017	6
2.1. Kuvendi i Kosovës: vizioni afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.....	6
2.2. Objektivat Strategjike.....	6
3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
4. KUVENDI I KOSOVËS NË FILLIM TË MANDATIT TË TRETË	10
4.1. Zhvillimet e tanishme dhe funksionimi i Kuvendit të Kosovës.....	10
4.2. Perspektiva Ekonomike e Kosovës.....	10
4.3. Programi i Kosovës për Integrim në BE.....	11
5. FUNKSIONET E KUVENDIT TË KOSOVËS	13
5.1. Funksioni legjislativ.....	13
5.2. Funksioni mbikëqyrës.....	15
5.2.1. Mbikëqyrja e buxhetit dhe kontrolli i financave publike	17
5.2.2. Komisionet për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP)	18
5.2.3. Praktikrat më të mira për funksionim të Komisioneve për Mbikëqyrjen e Financave Publike	19
5.2.4. Mbikëqyrja Parlamentare e Agjencisë për Inteligjencë dhe Siguri.....	20
5.2.5. Bashkëpunimi me institucionet e tjera të pavarura	20
5.3. Funksioni përfaqësues.....	21
5.3.1. Përcjellja e punimeve të Kuvendit nga qytetarët	21
5.3.2. Qasja e qytetarëve në informata të sakta dhe me kohë	22
5.3.3. Bashkëveprimi i qytetarëve me ligjvënësit	23
6. ORGANIZIMI I PUNËS NË KUVEND	25
6.1. Kryetari dhe Kryesia.....	25
6.2. Grupet Parlamentare	26
6.2.1. Grupi joformal i grave	27
6.3. Komisionet Parlamentare	27
6.4. Anëtarët e Kuvendit	29
6.5. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit	31
6.6. Administrata e Kuvendit	32
6.6.1 Baza ligjore dhe zhvillimet e fundit.....	32
6.6.2 Çështja e kohëzgjatjes së kontratave për të punësuarit permanent	32
6.6.3 “Modeli i kombinuar” për administratën e Kuvendit.....	32
6.6.4 Trupat administrative që kanë nevojë për mbështetje.....	33
6.6.5 Rekrutimi dhe trajnimi.....	34
6.7. Puna efikase e Kuvendit të Kosovës.....	35
6.7.1 Plani Vjetor i Punës i Kuvendit të Kosovës	35
6.7.2 Hapësira e punës dhe kushtet tjera për punë	36
6.7.3 Sistemi Informativ	36
6.7.4 Burimet Financiare	37
6.7.5. Analiza e buxhetit të Kuvendit për vitin 2008	38
6.7.6. Propozimi i buxhetit të ri	41

7. PËRFUNDIM	45
SHTOJCA 1. LISTA E TAKIMEVE TË EKIPIT VLERËSUES.....	46
SHTOJCA 2. BIBLIOGRAFI.....	48
SHTOJCA 3. ORGANOGRAMI I ADMINISTRATËS SË KUVENDIT.....	50

1. MIRËNJOHJE

Ky Raport është përmbyllje e projektit të përbashkët të Institutit Demokratik Kombëtar për Çështje Ndërkombëtare (NDI) në Kosovë dhe Misionit të Organizatës për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë (OSBE) në Kosovë me qëllim të përmirësimit të funksionimit të Kuvendit të Kosovës.

Bashkë me kolegen time Znj. Jožica Velišček vizituam Kosovën gjatë muajit qershor dhe korrik të vitit 2008 dhe me kolegët tanë në Kuvendin e Kosovës diskutuam për progresin e arritur dhe sugjerimet për rrugën që i pret në të ardhmen. Ne e çojmë përkushtimin e shprehur nga të gjithë bashkëbiseduesit për ta bërë Kuvendin një institucion me të vërtetë demokratik dhe funksional. Ne duam të falënderojmë veçanërisht Kryetarin e Kuvendit, Z.Jakup Krasniqin dhe Sekretarin e Përgjithshëm Z.Ismet Krasniqin.

Vlerësimi dhe rekomandimet e Raportit janë përgatitur për të ndihmuar udhëheqjen politike të Kuvendit dhe administratën e Kuvendit të ndërtojë një legjislaturë efektive transparente, e përgjegjshme para qytetarëve të cilave ajo u shërben.

Raporti ofron rekomandime për performancë efektive dhe efikase të Kuvendit të Kosovës dhe i paraqet udhëheqjes së Kuvendit dhe Administratës një seri zgjedhjesh dhe strategjish për zbatim. Ne shpresojmë që rekomandimet e Raportit do të merren parasysh dhe përfshihen në punën e Kuvendit të Kosovës. Jemi thellë të bindur që një hap i tillë do t'i ndihmojë Kuvendit të Kosovës në ndërtimin e traditës parlamentare demokratike dhe në konsolidimin e tij në pajtueshmëri me përvojat më të mira parlamentare Evropiane. Të rikujtojmë që Raporti është dokument “i gjallë” dhe si i tillë do të modifikohet vazhdimisht në pajtueshmëri me zhvillimet gjatë afatit të vet tre, gjashtë dhe nëntë vjeçar.

Autori dëshiron të vlerësojë kontributin e Znj. Jožica Velišček, ish Sekretare e Përgjithshme e Parlamentit të Republikës së Sllovenisë gjatë viteve (1992-2004) në përgatitjen e draftit të parë të raportit si dhe kontributet e jashtëzakonshme të personelit të NDI-it në Kosovë (Carlo Binda, Ian Perkins, Arben Kelmendi dhe Rinor Beka) dhe personelit të Misionit të OSBE-së në Kosovë (Franklin De Vrieze, Blerim Vela, Armend Bekaj dhe Artan Canhasi) të cilët ishin të përfshirë në përgatitjen e këtij raporti. Të dhëna jashtëzakonisht të çmueshme janë marrë nga niveli politik, ndërsa kontributi i tyre ndihmoi në formësimin e këtij raporti vlerësues dhe për këtë ne u jemi shumë mirënjohës.

Milan Martin Cvikl, deputet i Parlamentit të Republikës së Sllovenisë dhe ish kryetar i Komisionit për Kontrollin e Financave Publike (2004-2007)

Ljubljana, Tetor 2008

2. VIZIONI I KUVENDIT TË KOSOVËS PËR VITET 2011, 2014 DHE 2017

2.1. Kuvendi i Kosovës: vizioni afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë

Vizioni

Për një Kuvend i cili përmbush rolin e tij kushtetues si instiutioni më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës.

Ligjvënësit anekënd Evropës, janë duke zhvilluar diskutime rreth mënyrës së drejtimit të institucioneve dhe proceseve demokratike me qëllim të përmbushjes së nevojave të qytetarëve në shekullin e 21-të. Në Kosovë, i njëjti debat është duke u zhvilluar në të gjitha nivelet e qeverisjes. Deputetët e Kuvendit e të gjitha grupeve parlamentare kanë shprehur interesim në forcimin e rolit të tyre ligjvënës, mbikëqyrës dhe në krijimin e marrëdhënieve aktive me publikun në Kosovë. Diskutimi po zhvillohet në drejtim të gjetjes së mënyrave që Deputetët e Kuvendit të përmbushin detyrat e tyre gjatë seancave plenare, në komisione parlamentare, në menaxhimin e komunikimit të tyre me qytetarë dhe aktivitetet jashtë vendit.

Gjatë verës së këtij viti është zhvilluar një vlerësim gjithpërfshirës i punës së Kuvendit të Kosovës i cili shqyrtoi strukturën dhe procedurat dhe i ofroi Kuvendit, përmes këtij Raporti, një kornizë për përmirësimin e funksionimit të vet. Vlerësimi përfshin rekomandimet për fushat kryesore të jetës parlamentare dhe paraqet një qasje dinamike për adresimin e tyre gjatë një periudhe afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

Vlerësimi arriti të përfshijë tri tema kryesore në të cilat Kuvendi duhet ti përqendrojë energjitë e veta:

- Të sigurojë që puna e Kuvendit, e posaçërisht hartimi, rishikimi dhe shqyrtimi i politikës dhe legjislacionit zhvillohet në një ambient që inkurajon debatin politik, ndryshimet dhe progresin;
- Të sigurojë një platformë në të cilën të gjitha komunitetet e Kosovës mund të ushtrojnë ndikimin e tyre në procesin e vendimmarrjes;
- Të inkurajoj dhe zhvilloj vetëdijen publike mbi angazhimin në procesin parlamentar.

Plani Vlerësues dhe Strategjik paraqet objektivat strategjike dhe identifikon iniciativat përkatëse. Projektet dhe programet që nevojiten për tu zbatuar këto iniciativa do ti paraqiten Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe do të kërkohen burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare.

2.2. Objektivat Strategjike

Kuvendi i Kosovës ka identifikuar pesë objektiva strategjike në të cilat do ti fokusojë përpjekjet e veta dhe drejtojë aktivitetet e veta gjatë nëntë viteve të ardhshme dhe ka identifikuar iniciativat kryesore që duhet ndërmarrë për të mbështetur secilin objektiv. Objektivat janë siç vijon:

1. Të ndërtohet një funksionim efektiv i Kuvendit
2. Të sigurohet një proces ligjvënës gjithpërfshirës
3. Të ndihmohet procesi i hyrjes në Bashkimin Evropian dhe institucionet tjera Evropiane
4. Të përmirësohet të kuptuarit dhe perceptimi mbi punën e Kuvendit
5. Të sigurohet mbikëqyrje efikase ndaj Qeverisë

Organet politike të Kuvendit të Kosovës:

Parimet dhe besimet udhëheqëse që të gjitha organet politike të Kuvendit të Kosovës pritet të demonstrojnë në punën e tyre ditore duhet të jenë:

Respekti për procesin demokratik: Kuvendi i Kosovës njih rëndësinë e institucioneve parlamentare dhe procesit demokratik dhe zotohet që të punojë për të forcuar ato dhe ushqej respekt për to.

Vazhdimësi dhe ndryshime balancuese: Kuvendi i Kosovës do të sigurojë vazhdimësi institucionale dhe të mbështesë anëtarët e vet kur rolet e tyre evoluojnë dhe me këtë evoluon edhe institucioni.

Përsosmëri parlamentare: Kuvendi i Kosovës do të punojë për të pasur një legjislaturë që është efektive, e përgjegjshme dhe përfshirëse në raport me komunitetet minoritare dhe që është transparente dhe vepron me integritet në një mënyrë që është e përgjegjshme dhe etike.

Administrata e Kuvendit:

Parimet dhe besimet udhëheqëse që i gjithë personeli i administratës pritet të demonstrojë në punën e vet ditore duhet të jenë:

Profesionalizmi: I pasqyruar nga një përkushtim për përsosmëri, punë ekipore dhe i fokusuar në plotësimin e nevojave të anëtarëve të zgjedhur dhe qytetarit të cilit i shërben Kuvendi.

Integriteti: I pasqyruar me një paanshmëri politike, ndershmëri dhe respekt për shumëllojshmëri.

Përgjegjësia: E pasqyruar nga çdo anëtar i stafit që merr përgjegjësi për performancën individuale, të ekipit dhe të Kuvendit si dhe çiltërsia dhe transparenca ndaj publikut.

3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Puna efikase e Kuvendit të Kosovës, si institucioni më i lartë legjislativ, përfaqësues dhe mbikëqyrës, është kusht i domosdoshëm për demokraci në secilën shoqëri. Përmes funksionit të tyre përfaqësues, anëtarët e parlamentit pritet të promovojnë, argumentojnë apo debatojnë mbi shqetësimet dhe interesat e qytetarëve që ata përfaqësojnë. Nëse ata dështojnë në tejkalimin e kësaj sfide, qytetarët do të gjykojnë se Kuvendi nuk e meriton votën e tyre dhe duke ushtruar të drejtën e tyre demokratike ata mund të vendosin të mos u japin besimin në të ardhmen.

Megjithatë, kjo nuk është vetëm çështje politike. Performanca e deputetëve ngritet nëse ata ndihmohen nga një administratë parlamentare të mirë dhe efikase dhe nëse strukturat mbështetëse inkurajohen dhe janë të përgatitura tu krijojnë deputetëve kushte të kryejnë detyrat dhe obligimet e tyre parlamentare. Një Kryetar, një Kryesi dhe një Sekretar – përkrahës të ndryshimeve institucionale, një administratë efikase dhe proaktive, një mbështetje e kënaqshme financiare dhe një staf mbështetës i zhvilluar profesionalisht, janë pjesë e kësaj strukture që kontribuon në drejtim të ngritjes së kapacitetit të deputetëve për të kryer rolet e tyre të pritura si përfaqësues të popullit.

Kjo është arsyeja pse një vlerësim me rekomandime për zhvillim të mëtejshëm është një mjet i rëndësishëm që çdo parlament mund ta shfrytëzojë për të përmirësuar punën e vet dhe pozitën publike. Vitet e fundit, Kuvendi i Kosovës ka treguar përkushtim në forcimin e rolit të vet dhe në avancimin e procedurave parlamentare. Si shembull i aktiviteteve në këtë drejtim mund të merret reforma e quajtur “Plani i Kuvendit për Standardet 1” i paraqitur në qershor të vitit 2006 nga kryetari i atëhershëm i Kuvendit të Kosovës Z.Kolë Berisha¹. Si shembull tjetër mund të radhitet projekti i konzorciumit të katër parlamenteve evropiane i quajtur “Përkrahje e mëtejshme për Kuvendin e Kosovës”, i cili përmbylli punën e vet në janar të vitit 2008.

Raporti vlerësues, i titulluar me plotë të drejtë “*Mandati i ri, mundësi të reja*”, vjen si rezultat i konsultimeve me Kryetarin e Kuvendit, z.Jakup Krasniqin dhe sekretarin e përgjithshëm z.Ismet Krasniqin. Përkrahja dhe asistenca e Institutit Demokratik Kombëtar (NDI) dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë (OMIK) ka qenë e çmueshme në këtë proces. Meqë të dy organizatat punojnë me Kuvendin e Kosovës vite me radhë, ne patëm në dispozicion edhe kapacitetet dhe ekspertizën e tyre e cila na ndihmoi në përfundimin e suksesshëm të projektit.

Sa i përket metodologjisë së përdorur, më shumë se dyzet intervista janë zhvilluar me deputetë, dhe staf të administratës. Përveç kësaj, prezenca e autorëve në objektin e Kuvendit u mundësonte të shohin nga afër punimet në seancat plenare. Fillimisht, raporti jep një pasqyrë empirike mbi Kuvendin e Kosovës gjatë fillimit të mandatit të tretë. Ai gjithashtu përmend zhvillimet e fundit politike sikur Deklaratën e Pavarësisë të Kuvendit të Kosovës të shpallur më 17 shkurt 2008 dhe hyrjen në forcë të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008. Perspektiva ekonomike e Kosovës dhe Programi i Kosovës për Integrim në BE gjithashtu është pjesë e raportit. Këto zhvillime janë të rëndësishme për tu marrë parasysh për një vlerësim më realist të punës së Kuvendit deri më tani.

Kapitulli i pestë fokusohet në funksionet e Kuvendit të Kosovës. Në këtë kapitull janë dhënë rekomandimet të cilat, nëse miratohen, ndihmojnë Kuvendin e Kosovës që të përmirësojë funksionet e veta kushtetuese. Sa i përket *funksionit legjislativ*, sugjerohet që në Rregulloren e

¹ Më 1 Qershor 2006, z.Berisha paraqiti një plan gjithëpërfshirës reformash të quajtur “Plani i Kuvendit për Standardet”. Bazuar në rekomandimet e NDI-it në Kosovë, plani paraqet ndryshimet në Rregulloren e Punës lidhur me miratimin e rendit të ditës të seancës plenare, pyetjet për Qeverinë dhe interpelancat. Objektivi ishte që të bëhet një rend i ditës i seancës plenare më efektiv dhe fleksibil dhe gjithashtu të rritet mbikëqyrja parlamentare ndaj qeverisë. Përveç kësaj, plani i reformave i jep përgjegjësinë Komisionit të Kuvendit për Buxhet dhe Financa të hartojë propozimin e buxhetit të Kuvendit. Në raportin e vet vjetor të vitit 2006 për Kosovën, Komisioni Evropian gjithashtu përmendi që funksionimi i Kuvendit është përmirësuar gjatë vitit 2006, Rregullorja e punës kryesisht është respektuar dhe që një pako e rëndësishme reformash është aprovuar në Qershor të vitit 2006. Shih Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2006) “Raporti i Progresit për Kosovën 2006”, Bruksel, fa. 7.

Punës të forcohet roli i Komisioneve Parlamentare përmes një procesi efikas legjislativ. Kërkohej që Komisioneve Parlamentare tu jepet kohë e mjaftueshme dhe mbështetje administrative për tu mundësuar atyre shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjeve para se ato ti dërgohen Kuvendit për miratim. Duhet theksuar se kjo është vitale, nëse funksioni legjislativ shërben si element që ndihmon punën e Qeverisë dhe Kuvendit. Sa i përket *funksionit mbikëqyrës* rekomandohet, në mes tjerash, që Rregullorja e Punës duhet të kufizojë mundësinë e ministrave të shmangin pyetjet dhe gjithashtu të sigurohet personel adekuat si dhe mbështetje financiare dhe teknike për komisionet e cila është e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve të tyre mbikëqyrëse. Sa për ilustrim, theksi vihet në konsolidimin e mekanizmave mbikëqyrës ndaj buxhetit publik dhe financave dhe gjithashtu sektorit të sigurisë, si shembuj të rëndësishëm të mbikëqyrjes së qeverisë gjatë këtij mandati. Sa i përket *funksionit përfaqësues*, është e qartë se qytetarët duhet të kenë qasje më të hapur dhe më të lehtë në punën e Kuvendit. Gjithashtu, kontakti me organizatat e shoqërisë civile duhet të institucionalizohet ashtu që ato të përfshihen në dëgjimet e organizuara nga komisionet parlamentare si çështje e një rutine ditore dhe e një transparence të plotë për punën e Kuvendit.

Kapitulli i gjashtë përqëndrohet në organet brenda Kuvendit të Kosovës, duke filluar nga Zyra e Kryetarit dhe Kryesia, Grupet Parlamentare dhe Komisionet Parlamentare, Deputetët e Kuvendit dhe në fund Sekretari dhe Administrata e Kuvendit. Është bërë një analizë e bashkëveprimit ndërmjet këtyre organeve dhe janë dhënë rekomandimet për përmirësimin e bashkëveprimit dhe të ekuilibrit të përgjegjësiave politike. Në rekomandimet e dhëna theksi është vënë në faktin që me Rregulloren e re të Punës, të harmonizohet roli i udhëheqjes së Kuvendit me Kushtetutën e re. Kuvendi duhet të punojë veçanërisht në drejtim të përgatitjes së një plani zhvillimor për përkrahje financiare, profesionale dhe administrative për deputetë dhe grupe parlamentare. Sa i përket komisioneve parlamentare, është e rëndësishme që atyre tu sigurohen hapësira për punë administrative dhe logjistike. Sekretari i Përgjithshëm duhet të luaj rolin e tij në lehtësimin dhe krijimin e linjave të qarta të komunikimit në mes zyrës së tyre, stafit civil dhe stafit politik. Rekomandimet e dhëna do të ndihmonin ndërtimin e një administrate më të mirë dhe më efektive. Kjo do të mundësonte kushte më të mira pune për deputetë dhe do të kishte efekt pozitiv në performancën e përfaqësuesve politik.

Raporti merr parasysh Rregulloren e Punës të Kuvendit të Kosovës, si akt themelor që rregullon organizimin dhe punën e Kuvendit, detyrat dhe të drejtat e Anëtarëve të Kuvendit dhe gjithashtu organeve tjera që marrin pjesë në procesin legjislativ. Në pajtueshmëri me Rregulloren e Punës, rekomandimet e dhëna mendohet të kontribuojnë që të kemi seanca më efektive, një ndarje të qartë të punës në seanca plenare dhe komisione parlamentare, një rol më të madh për këta të fundit dhe një zbatim më efikas të funksionit mbikëqyrës të Kuvendit.

Një theks i veçantë në këtë raport është vënë në ruajtjen e autonomisë së Kuvendit, si një prerogativë e nevojshme për përmbushjen e obligimeve kushtetuese. Autonomia e Kuvendit në këtë raport kategorizohet në 1) autonominë Rregulluese (procedurale) – e cila i mundëson Kuvendit të miratojë Rregulloren e vet të Punës; 2) autonominë organizative / administrative – e cila i jep Kuvendit të drejtën të vendos në mënyrë të pavarur mbi çështjet organizative; 3) autonominë financiare – e cila i ofron Kuvendit hapësirë të caktuar pa pengesë propozim buxhetin për mbështetje të punës së vet; dhe 4) autonominë e sigurisë – e cila i mundëson Kuvendit të vendosë për mënyrën se si të mbrohet ai dhe deputetët.

Zbatimi i suksesshëm i kategorive të mësipërme do të rezultojë me mbështetje adekuate administrative për Deputetët e Kuvendit e cila duhet të sigurohet nga Administrata Qendrore e Kuvendit.

Raporti “*Mandati i ri, mundësi të reja*”, përmban rekomandime të hollësishme mbi çdo çështje të diskutuar dhe shpresojmë të merret parasysh dhe përfshihet në punën e përditshme të Kuvendit të Kosovës. Ne jemi thellë të bindur që një hap i tillë do të ndihmojë Kuvendin e Kosovës në përmirësimin e traditës së vet të re parlamentare mjaft demokratike dhe ti ndihmojë në konsolidimin e saj në pajtueshmëri me përvojat më të mira parlamentare Evropiane.

4. KUVENDI I KOSOVËS NË FILLIM TË MANDATIT TË TRETË

4.1. Zhvillimet e tanishme dhe funksionimi i Kuvendit të Kosovës

Më 19 Dhjetor 2007, procesi elektoral i vitit 2007 u përmbyll me certifikimin e rrethit të dytë të zgjedhjeve qendrore dhe për kryetar komune. Më 9 Janar 2008 Kuvendi zgjodhi Kryetar të Kuvendit Jakup Krasniqin dhe anëtarët e Kryesisë së Kuvendit dhe e rizgjodhi Fatmir Sejdiun Kryetar të Kosovës. Në të njëjtën ditë, Kuvendi votoi një qeveri të re të koalicionit.² Gjashtë nga 10 anëtarët Serb të Kuvendit dhanë betimin atë ditë. Përfaqësuesve të partive politike që përfaqësojnë komunitetin Serb të Kosovës iu dha Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ndërsa Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor iu dha partisë që përfaqëson komunitetin Turk të Kosovës.

Më 17 Shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës mbajti një seancë gjatë së cilës miratoi “deklaratën e pavarësisë”, duke shpallur Kosovën Vend të pavarur dhe sovran.³ Deklarata theksonte që Kosova pranon plotësisht obligimet e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Më 9 Prill 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi Kushtetutën e Kosovës me një pako të ligjeve që mbulojnë decentralizimin dhe kufijtë dhe autorizojnë krijimin e një Ministrie të Kosovës të Punëve të Jashtme dhe Shërbimit të Inteligjencës⁴ që sipas orarit hyri në fuqi më 15 Qershor 2008. Kushtetuta është hartuar në atë mënyrë që ajo i heq efektivisht UNMIK-ut kompetencat e veta si administratë e përkohshme civile.⁵

Pas deklaratës së pavarësisë së Kosovës, raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ra vëren se Serbët e Kosovës, me përkrahjen e autoriteteve serbe, kanë zgjeruar bojkotin e tyre ndaj institucioneve të Kosovës duke përfshirë Doganat e UNMIK-ut, Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK), Sistemin Korrektues të Kosovës, sistemin gjyqësor, administratën komunale dhe hekurudhat e UNMIK-ut.⁶ Katër anëtarë serb të Kuvendit të Kosovës vazhduan të bojkotojnë punën e Kuvendit që filloi më 17 Shkurt. Megjithatë, ky bojkotim nuk ka qenë i pandërprerë. Gjashtë anëtarët e mbetur të serbëve të Kosovës të cilët janë anëtarë të grupit parlamentar të Partisë Liberale Serbe (SLS) ndërprejnë bojkotimin e seancave plenare të Kuvendit më 19 Mars. Dy ministrat e Partisë Liberale Serbe gjithashtu filluan të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Qeverisë. Njëmbëdhjetë shërbyes civil Serb të Kosovës janë duke punuar në Kuvend.⁷

4.2. Perspektiva Ekonomike e Kosovës

Gjatë nëntë viteve të kaluara, komuniteti ndërkombëtar ka investuar në ndërtimin e institucioneve të cilat do të siguronin stabilitet politik dhe social në të ardhmen. Gjatë kësaj periudhe, administrata ndërkombëtare në Kosovë ka bartur gradualisht pjesë të përgjegjësive të veta të sigurisë, qeverisjes dhe administrative tek institucionet lokale të Kosovës. Veç kësaj, ekonomia e Kosovës ka shënuar progres të ndjeshëm gjatë kalimit në një sistem të bazuar në ekonomi të tregut por ende është shumë e varur nga komuniteti ndërkombëtar dhe diaspora sa i përket asistencës financiare dhe teknike. Kosova, qetësisht, po integrohet gjithnjë e më shumë në ekonominë rajonale.⁸

² Kombet e Bashkuara (2008), “Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë”, S/2008/211, Nju Jork, f. 1.

³ Kombet e Bashkuara (2008), po aty.

⁴ Kombet e Bashkuara (2008), “Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë”, S/2008/458, Nju Jork, f.2

⁵ Kombet e Bashkuara (2008), “Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë”, S/2008/354, Nju Jork, f.2

⁶ Kombet e Bashkuara (2008), “Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë”, S/2008/211, Nju Jork, f.2

⁷ Kombet e Bashkuara (2008), “Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë”, S/2008/458, Nju Jork, f.2

⁸ Kombet e Bashkuara (2008), po aty, f.11

Agjencitë ndërkombëtare kanë punuar me institucionet lokale dhe ndërkombëtare për të financuar rehabilitimin e infrastrukturës së dëmtuar dhe të lënë pas dore dhe kanë punuar në futjen e Kosovës në rrugën e rritjes së qëndrueshme ekonomike. Në kohën e fundit ka pasur disa shenja inkurajuese të progresit. Qytetarët e Kosovës janë më të varfërit në Evropë me të ardhura vjetore për person prej vetëm € 1.150⁹. Më 15 Shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi buxhetin për vitin 2008, siç ishte aprovuar paraprakisht nga Këshilli Ekonomik Fiskal. Buxheti i aprovuar kap shumë prej €1.1 miliard, një ngritje substanciale në krahasim me buxhetin prej €718 milionësh për vitin 2007¹⁰.

Bruto prodhimi vendor (GDP) është llogaritur të jetë rritur për 3.5 për qind në vitin 2007, pavarësisht zvogëlimit të asistencës së jashtme, nga 21.9 në 20.5 për qind të GDP-së dhe një zvogëlimi në shpenzime të qeverisë nga 31.2 në 27.7 për qind. Rritja e GDP-së i është atribuar, kryesisht, zhvillimit në sektorin lokal privat.¹¹ Sipas raportit të KB-së, Qeveria e Kosovës duhet të zbatojë plotësisht zotimet e veta ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar, duke përfshirë nevojën për kontroll më të rreptë dhe rishikim të kriterit të përshtatshmërisë për pensionet themelore dhe përfitimet tjera sociale; shmangie të skemave të reja të përfitimit social; përshtatje të legjislacionit të propozuar me burimet në dispozicion dhe planifikimin e detajuar për zvogëlimin e propozuar të të punësuarve publik.¹²

Në vitin 2005 dhe 2006, është llogaritur që 45.1 për qind e popullatës jetonin në nivelin e varfërisë me 16.7 për qind të popullatës në varfëri të skajshme.¹³ Tani papunësia – e llogaritur rreth 40% - është një problem i rëndë që inkurajon migrimin jashtë vendit. Rritja ekonomike kryesisht nxitet nga sektori privat – biznese të vogla të shitjes me pakicë. Kështu, Kosova është e fundit në rajonin e Ballkanit sipas Indeksit mbi Zhvillimin Njerëzor të UNDP-së. Pikët e llogaritura për Kosovën në kohë të fundit për vitin 2007 tregojnë që ka pasur një ndryshim të vogël pozitiv: Rezultati i përgjithshëm i IZHNJ-or për vitin 2007 është 0.745, krahasuar me 0.740 në vitin 2006.¹⁴

Sipas një raporti të KB-së, një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) vizitoi Kosovën në Prill të vitit 2008 për të vlerësuar kornizën makroekonomike dhe politikat fiskale. FMN korrigjoi shifrat rreth bruto prodhimit vendor të Kosovës (GDP), të cilat tani llogariten të jenë €3,343 milion (€1,573 për person) në vitin 2007, dhe parashihet një rritje reale e GDP-së prej rreth 5 për qind në vit gjatë një periudhe pesë vjeçare.¹⁵ Qeveria e Kosovës organizoi një konferencë të donatorëve më 11 Korrik 2008 dhe morri zotim për investime prej 1,5 miliard eurosh.

4.3. Programi i Kosovës për Integrim në BE

Grupi Ndërkombëtar i Krizave ka vërejtur që BE është mirëbërësi më i madh i Kosovës dhe mundësia e hyrjes finale e stimulon atë të fokusohet në energjitë e veta.¹⁶ Për shkak të statusit politik të Kosovës BE ka krijuar një instrument unik për Kosovën në kornizën e procesit të stabilizimit asociimit (PSA). Mekanizmi Përcjellës i Stabilizim Asociimit për Kosovën është krijuar me qëllim që të rregullojë marrëdhëniet strukturore me BE dhe të kontribuojë për stabilizimin e saj të brendshëm politik, ekonomik dhe rajonal përmes zbatimit të reformave në pajtim me standardet e BE-së.¹⁷ Gjatë vitit 2007, është themeluar një strukturë e re e takimeve

⁹ ECIKS (2008), "Udhëzues për Investitorë: Investimi në Kosovë 2008", faqe 6.

¹⁰ Kombet e Bashkuara (2008), "Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për UNMIK-un", S/2008/211, New York, faqe 15

¹¹ UNDP (2007), "Energjia për Zhvillim – Raport për Zhvillimin Njerëzor në Kosovë 2007", Prishtinë, f.2.

¹² Kombet e Bashkuara (2008), "Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë", S/2008/211, Nju Jork, f. 16.

¹³ Enti i Statistikave të Kosovës 2007a. Në Raportin e UNDP-së për vitin 2006 për Evropë dhe rajonin e nivelin e varfërisë kombëtare për Kosovën në vitin 2004 ishte dhënë si PPP €1.60 (€1.20) në ditë, me shkallë ekstreme të varfërisë e dhënë si PPP \$0.85 në ditë. Informatat e marra nga faja e internetit: www.ks-gov.net/esk.

¹⁴ UNDP (2007), "Energjia për Zhvillim – Raport për Zhvillimin Njerëzor në Kosovë 2007", Prishtinë, f.3.

¹⁵ Kombet e Bashkuara (2008), "Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë", S/2008/458, Nju Jork, f. 5.

¹⁶ Grupi Ndërkombëtar i Krizave (2007), 'Ndërprerja e rrugës qorre të Kosovës: Përgjegjësi e Evropës', Raporti i Evropës numër 185, Bruksel, f.12.

¹⁷ Van Meurs W., dhe Weiss S. (2003), 'Evropa e Ardhme: Evropa Jug-Lindore pas Selanikut', Qendra për Hulumtim të Politikave & Fondacioni Bertelsmann, f.6.

sektoriale në kuadër MPS në fushat e qeverisje e mirë, ekonomi, treg të brendshëm, inovacion dhe infrastrukturë. Struktura e re siguroi mekanizmin për një analizë më të detajuar të pajtueshmërisë së legjislacionit, praktikave dhe politikave në Kosovë me standardet Evropiane.¹⁸

Hyrja në Bashkimin Evropian do të paraqes një nxitje për forcimin e rendit institucional në vendet e Evropës Jug-Lindore, duke përfshirë Kosovën. Miratimi dhe implementimi i legjislacionit të BE-së sigurisht që do të kërkojë reforma dhe një rritje të kapacitetit të pothuaj të gjitha institucioneve publike në Kosovë të cilat sigurisht do të përfshijnë të gjitha fushat e aktiviteteve të shtetit.

Vlerësimi i SIGMA's mbi shërbimet publike të Kosovës dhe kornizën administrative tërheq vëmendjen që mos koherenca e kornizës ekzistuese ligjore administrative në Kosovë rezultoi me kornizë ligjore të fragmentuar dhe nganjëherë të papajtueshme dhe kontradiktore e cila, së bashku me kapacitetet vazhdimisht të dobëta zbatuese, pengon implementimin adekuat dhe vendos një barrë shtesë mbi institucionet e Kosovës kur të rishikohet korniza ekzistuese ligjore dhe bërja e saj koherente dhe në pajtueshmëri me Acquis Communautaire dhe standardet e përgjithshme Evropiane.¹⁹

BE u jep udhëzime autoriteteve për reformat prioritare përmes Partneritetit Evropian.²⁰ Progresi në këto reforma prioritare inkurajohet dhe monitorohet përmes MPS. Më 13 Shkurt 2008, Bashkimi Evropian u pajtua për një Plan të Ri të Partneritetit Evropian për Kosovën.²¹ Qeveria e Kosovës e aprovoi Planin e Veprimit për Partneritet Evropian në Korrik të vitit 2008.²² Ky plan parasheh formimin e një Komisioni Koordinues të Nivelit të Lartë me anëtarë Kryetarin e Kosovës, Kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe Kryeministrin e Kosovës që përfaqësojnë tri degët e fuqisë në Kosovë. Ky komision do të diskutojë dhe jap udhëzime strategjike për Kosovën në lidhje me çështjet e integriteteve Evropiane.

Megjithëse Komisioni Evropian në Raportin e Progresit për vitin 2007 vërejti që Komisioni për marrëdhënie ndërkombëtare dhe Integritete Evro-Atlantike nuk ka qenë i përfshirë në shqyrtimin e projektligjeve dhe pajtueshmërinë e tyre me standardet e BE-së²³, në fillim të mandatit të tretë në Janar 2008, Komisioni i ri për Integritete Evropiane ka demonstruar një përfshirje dhe përkushtim më të madh për të arritur standardet e BE-së.

Prandaj, Kuvendi i Kosovës duhet ta pozicionojë veten qartë, në lidhje me çështjen e integriteteve Evropiane veçanërisht sa i përket ndarjes së detyrave ndërmjet degës ekzekutive dhe legjislative. Kështu, është e nevojshme të ekzistojë një qasje proaktive e Kuvendit të Kosovës në lidhje me këtë, duke filluar nga definimi i qasjes së Qeverisë së Kosovës lidhur me hyrjen në BE ndjekja me vëmendje e procesit negociues dhe më vonë lehtësimi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

¹⁸ Komisioni Evropian (2007), "Kosova sipas RKS KB 1244 Raporti i Progresit 2007", SEC (2007) 1433, Bruksel, f.5.

¹⁹ SIGMA (2006), "Kosovë: Shërbimi Publik dhe Korniza Administrative", Raporti Vlerësues i SIGMA-s, Paris, f.2.

²⁰ Komisioni Evropian (2007), po aty, f.6.

²¹ Kombet e Bashkuara (2008), "Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë", S/2008/211, Nju Jork, f. 4.

²² Zyra e Kryeministrit (2008), "Konkluzionet nga takimi i 29-të i Qeverisë së Republikës së Kosovës", Deklarata për Shtyp e Qeverisë, 31 Korrik 2008, Prishtinë në <http://www.ks-gov.net/pm/lajme/tabid/62/EntryID/867/Default.aspx>

²³ Komisioni Evropian (2007), po aty, f.8.

5. FUNKSIONET E KUVENDIT TË KOSOVËS

Si çdo parlament i shteteve demokratike edhe Kuvendi i Kosovës ushtron tri funksione kryesore: funksionin legjislativ (miratimin e ligjeve), funksionin përfaqësues (duke vepruar në emër të votuesve dhe qytetarëve) dhe funksionin e mbikëqyrjes së punës së degës ekzekutive. Roli më i rëndësishëm që parlamenti luan është të bëjë ligje të reja dhe ndryshojë dhe përmirësojë të vjetrat. Shumica e ligjeve përgatiten nga departamentet e qeverisë dhe paraqiten në parlament nga ministrat e qeverisë. Deputetët pasqyrojnë interesat e zgjedhësve dhe adresojnë problemet e tyre. Qeveria i zbaton ligjet dhe vendimet tjera të Parlamentit. Megjithatë, Parlamenti ka autoritetin të mbikëqyrë çfarë bën qeveria, veçanërisht si e shpenzon paratë publike. Opozita luan rol të rëndësishëm gjatë kësaj mbikëqyrjeje.

E gjithë fushëveprimtaria e përcaktuar me Kushtetutë përfshin aktivitete që mund të kategorizohen brenda njërit prej tre funksioneve kryesore të secilit parlament demokratik. Më poshtë, ne do të elaborojmë praktikën e ushtrimit të këtyre funksioneve nga Kuvendi i Kosovës.

5.1. Funksioni legjislativ

Një proces efikas legjislativ, organizimi dhe planifikimi i mirë i punës në komisionet parlamentare paraqesin kushte të rëndësishme për zbatim cilësor të kompetencave të degës legjislative. Ky segment meriton vëmendje të veçantë në Rregulloren e Punës së Kuvendit sepse ka një numër të madh të projektligjeve që duhet shqyrtuar si dhe harmonizuar me Kushtetutën e re dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian. Në fund, reputacioni i Kuvendit të Kosovës do të varet nga numri dhe cilësia e legjislacionit të miratuar.²⁴

Është e rëndësishme që ndryshimet në Rregulloren e Punës të kenë për qëllim krijimin e një procesi sa më efikas të miratimit të ligjeve. Një parim që duhet ndjekur është “kurrë mos diskuto dy herë të njëjtën çështje”, e cila do të thotë se çdo shqyrtim në komisionet parlamentare dhe seancat plenare duhet pasur qëllim të definuar qartë dhe që nuk duhet përsëritur diskutimin.

Në këtë procedurë, shqyrtimi i parë mendohet të sigurojë informata të përgjithshme për deputetë mbi projektligjin dhe vetëm me kërkesë specifike të një numri të caktuar të deputetëve mund të ndodhë diskutimi në seancën plenare që duhet të rezultojë me amendamente për shqyrtim të mëtejshëm të projektligjit. Shqyrtimi i parë duhet të ndodhë vetëm kur një grup i deputetëve konsideron që projektligji lë shumë pyetje të hapura apo çështje kushtetuese që nuk mund të përballen gjatë procesit legjislativ.

Shqyrtimi i dytë parashihet për diskutime dhe votim mbi nenet dhe amendamentet e propozuara, së pari në komisionet parlamentare, ku metoda punuese mundëson pjesëmarrje aktive të ekspertëve të jashtëm dhe organizatave relevante (universiteti, oda ekonomike etj). Më vonë, gjatë seancës plenare, deputetët votojnë mbi nenet e amendamentuara të projektligjit dhe amendamentet e reja të propozuara nga deputetët.

Shqyrtimi i tretë shërben për të përmirësuar gabimet e mundshme që mund të kenë ndodhur gjatë miratimit të amendamenteve në shqyrtimin e dytë në seancën plenare. Diskutimet në seancën plenare duhet zhvilluar vetëm mbi çështjet që nuk janë zgjidhur nga komisionet parlamentare.

Reforma e mundshme e procesit legjislativ varet nga vullneti politik i udhëheqjes së Kuvendit gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të Rregullores së re të Punës. Pa ndryshime të mëdha në Rregulloren e Punës është i pamundur të bëhet reformimi dhe ngritja e efikasitetit të procesit legjislativ, forcimi i rolit të komisioneve, grupeve parlamentare dhe të përmirësohen planet e punës. Përvoja e deritanishme në Kuvendin e Kosovës fatkeqësisht ka dëshmuar që shumë komisione parlamentare nuk kanë përmbushur plotësisht rolet e tyre, kryesisht për arsyet në vijim: koha tepër e shkurtër për punë në disa komisione parlamentare, mungesa e planeve të

²⁴ Për më shumë informata referoju “Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës”, miratuar më 20 Maj 2005 dhe amendamentuar më 1 Qershor 2006, Rregulla 33-40, f. 35-40;

punës, përkrahja e pamjaftueshme e ekspertëve dhe mungesa e përkrahjes nga ana e grupeve parlamentare për punën e deputetëve në komisione parlamentare.

Një proces efikas legjislativ nënkupton një rol të rëndësishëm për komisionet parlamentare, veçanërisht ato funksionale. Fuqia e tyre pasqyrohet përmes rolit të tyre aktiv në të gjitha aktivitetet parlamentare, dhe kryesisht në procesin legjislativ, në krijimin e politikave dhe realizimin e aktiviteteve mbikëqyrëse mbi ekzekutivin dhe organet tjera. Në komisionet funksionale parlamentare diskutimi mbi projektligjet bëhet pa kufizime me përkrahjen e ekspertëve dhe palëve të interesuara. Në të njëjtën mënyrë, diskutimi duhet mbajtur në komisionet tjera bazuar në kompetencat e tyre dhe edhe ato duhet pasur rastin të shprehin opinionet e tyre rreth draft propozimeve dhe tu përcjellin ato komisioneve funksionale parlamentare për ti rishikuar ato gjatë diskutimeve të tyre. Raportet mbi aktin e propozuar mund të paraqiten në seancën plenare vetëm nga komisioni funksional parlamentar. Duhet marrë në konsideratë puna e komisioneve parlamentare dhe rolet specifike dhe kompetencat që ato kanë.²⁵

Është e nevojshme që deputetët të kenë mjaft kohë për punën e komisioneve parlamentare dhe përgatitjen e raporteve mbi draft propozimin. Pa këtë raport, nuk duhet pasur diskutim në seancë plenare. Komisionet parlamentare kanë një përfaqësim proporcional të deputetëve, përmes përfaqësuesve të Grupeve të tyre Parlamentare. Gjithashtu, ky lloj i përfaqësimit duhet të jetë në delegacionet e Kuvendit të Kosovës, bashkëpunimin ndër-parlamentar dhe organizatat tjera ndërkombëtare. Delegacionet duhet gjithmonë të përbëhen nga deputetët të koalicionit qeverisës dhe opozitës. Kjo paraqet një standard ndërkombëtar demokratik.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim (KDIK) është një nga dy komisionet kryesore të Kuvendit të Kosovës dhe ka një rol të rëndësishëm në procesin legjislativ. Çdo projektligj që paraqitet në Kuvendin e Kosovës duhet të shqyrtohet nga KDIK. Ai mund të bëjë rekomandime me qëllim që të siguroj që të drejtat dhe interesat e komuniteteve janë adresuar si duhet. KDIK gjithashtu mund të iniciojë legjislacion brenda Kuvendit me qëllim që të adresojë shqetësimet e Komunitetit.²⁶

Procesi legjislativ i Kuvendit të Kosovës është dizajnuar të rrisë në maksimum pjesëmarrjen dhe sigurojë mundësi për komunitetet të paraqesin shqetësimet e tyre. Krahas KDIK ka edhe mekanizma tjerë të mbrojtjes së komuniteteve brenda Kuvendit. Më të rëndësishmit janë:

1. Mundësia që çdo anëtar i Kryesisë së Kuvendit të kërkojë që një projektligj ti dorëzohet KDIK-së, dhe me shumicë, të rekomandojë që të drejtat dhe interesat e komuniteteve të adresohen në mënyrë adekuate. 2. Ekzistenca e Komisioneve në të cilat komunitetet duhet të përfaqësohen sipas ligjit dhe 3. Procedura e Interesit Vital e cila është dizajnuar të mbrojë interesat minoritare dhe inkurajojë angazhimin e tyre në procesin legjislativ. Nëse një projektligj ka kaluar procedurat, çdo anëtar i Kuvendit i përkrahur nga pesë anëtarë tjerë të Kuvendit mund të paraqesë brenda 48 orësh para se Kryetari të nënshkruaj ligjin, një mocion Kryesisë së Kuvendit duke potencuar që ligji apo dispozitat e caktuara të tij shkelin interesat e Komunitetit të cilit ai apo ajo i takon. Mocioni duhet të paraqesë një sqarim të argumentuar të shkeljes së pohuar.

Rekomandime:

- Të hartohen planet e punës që do tu mundësonin komisioneve parlamentare mjaft kohë për përgatitje dhe diskutim;
- Të zbatohet parimi i procesit efikas legjislativ "kurrë mos e diskuto dy herë të njëjtën çështje", duke dërguar projektligjet drejtpërdrejt në komisionin funksional para shqyrtimit të parë. Gjatë shqyrtimit të parë, Kuvendi dëgjon mendimin e komisionit funksional në

²⁵ Misioni i OSBE-së në Kosovë (2008), "Monitorimi i punës së Kuvendit të Kosovës. Përpilimi i Raporteve mbi Monitorimin e Kuvendit, 5 Gusht 2006- 30 Nëntor 2007", Prishtinë, f.7;

²⁶ Tani, anëtarë të KDIK-së janë dy anëtarë nga secili komunitet Kosovar i zgjedhur në Kuvend. Sipas Kushtetutës, parashihet që çështja e anëtarëve të KDIK-së të jetë si vijon: një e treta e anëtarëve nga komuniteti shumicë, një e treta e anëtarëve përfaqësues komunitetin Serb të Kosovës dhe një e treta e anëtarëve përfaqësues komunitetet tjera jo-shumicë.

lidhje me cilësinë e ligjit dhe nëse projektligji përmbush kërkesat për miratim në shqyrtimin e parë;

- Të punohet duke iu përmbajtur në mënyrë strikte Rregullores së Punës kur Kuvendi është në seanca plenare dhe të mos diskutohet pa raportin e komisionit funksional parlamentar.
- Të hartohet dhe miratohet Rregullorja e re Punës me konsensusin më të gjerë të mundshëm të koalicionit qeverisës dhe opozitës. Kjo do të siguronte respektimin e Rregullores së re të Punës dhe një konsensus më të gjerë të mundshëm të koalicionit qeverisës dhe opozitës;

5.2. *Funksioni mbikëqyrës*

Në një sistem ku demokracia parlamentare përcaktohet me Kushtetutë, detyrat dhe përgjegjësitë e çdo Parlamenti dhe të gjithë deputetëve janë që të bëjnë mbikëqyrjen parlamentare të degëve tjera të qeverisë dhe atyre organeve që janë të obliguara ti raportojnë parlamentit bazuar në Kushtetutë dhe ligj. Legjislaturat mund ta mbajnë degën ekzekutive përgjegjëse përmes disa mjeteve si: parashtrimi i pyetje zyrtarëve të lartë të qeverisë (duke përfshirë ministrat), rishikimit apo konfirmimit të takimeve me ekzekutivin, themelimit të komisioneve hetuese, dhe paraqitjes së mocionit të mosbesimit për qeverinë. Mekanizmat e përgjegjësisë dallojnë sipas vendit bazuar në kompetencat e legjislaturës të definuara me kushtetutë, marrëveshjet institucionale në mes degëve të qeverisë, ndarjes së autoritetit ndërmjet qeverive lokale dhe nacionale dhe shkallës së legjitimitetit të dhënë në legjislaturë.²⁷ Sikur që është rasti në shumë legjislatura të botës sot, Kuvendi i Kosovës ka një përzierje mekanizmash të garantuar me Kushtetutë dhe Rregullore të Punës që lejojnë mbikëqyrje të degës ekzekutive. Këta mekanizma përfshijnë Kohën për Pyetje Parlamentare, pyetjet për përgjigje me shkrim, interpelancat, Komisionet Hetuese, Mekanizmat Mbikëqyrës Buxhetor, mbikëqyrjen nga komisionet parlamentare dhe mocioni i mosbesimit.

Kuvendi nuk ka qenë shumë efektiv në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse gjatë mandatit të parë kryesisht për shkak të mungesës së përvojës dhe gjithashtu për shkak të koalicionit të gjerë që qeverisi vendin për tre vite. Gjatë mandatit të dytë dhe veçanërisht pas ndryshimeve në udhëheqjen e Kuvendit dhe inicimit të reformave institucionale, shfrytëzimi i mekanizmave mbikëqyrës nga opozita dhe roli mbikëqyrës i Kuvendit është ngritur dukshëm.²⁸ Përkundër progresit të konsiderueshëm, shfrytëzimi i mekanizmave mbikëqyrës mund të përmirësohet ende dhe cilësia e mbikëqyrjes në përgjithësi mund të avansohet përmes plotësimeve në Rregulloren e Punës, në pjesën për mekanizmat mbikëqyrës dhe përmes grupeve parlamentare më aktive dhe me përkrahje adekuate.

Koha për pyetje parlamentare është mekanizmi më efektiv mbikëqyrës në Kuvend, duke marrë parasysh ndryshimet e vitit 2006 në Rregulloren e Punës. Koha për pyetje, është pjesa e parë statike në rendin e ditës të çdo seance plenare dhe statistikat e fundit tregojnë se ka një ngritje të madhe në numrin dhe cilësinë e pyetjeve ndërsa shumica e deputetëve ankohen se përgjigjet nga ministrat nuk janë adekuate.²⁹ Mangësitë kryesore në funksionimin e kohës së pyetjeve janë mungesa e Ministrave, cilësia e pyetjeve të dorëzuara dhe publikimi i pyetjeve në të cilat nuk është dhënë përgjigje në buletin, i cili u mundëson ministrave të shmangin pyetjet kritike.³⁰ Kryetari i Kuvendit duhet të insistojë që Ministrat të jenë të pranishëm gjatë Seancave Plenare dhe gjithashtu në takimet e komisioneve parlamentare. Vetëm në pak raste mund të arsyetohet mungesa e tyre. Caktimi i kushteve për praninë e Ministrave do të ndihmojë nëse Kuvendi do të kishte një orar vjetor pune të Kuvendit dhe bazuar në atë plan Ministrat do të harmonizonin aktivitetet e tyre me obligimet në Kuvend.

Interpelanca si një mekanizëm mbikëqyrës nuk shfrytëzohet shpesh në Kuvend. Çuditërisht, deputetët preferojnë më shumë debate të hapura se sa interpelanca të cilat u japin mundësinë

²⁷ Instituti Demokratik Kombëtar për Çështje Ndërkombëtare (2006) "Drejt Zhvillimi të Standardeve Ndërkombëtare për Legjislaturat Demokratike", Uashington;

²⁸ Komentet e marra gjatë një takimi me udhëheqësin e një grupi parlamentar të koalicionit, i mbajtur më 3 Qershor 2008;

²⁹ Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës", Rregulla 26;

³⁰ Komentet e marra gjatë një takimi me udhëheqësin e një grupi parlamentar të opozitës, i mbajtur më 3 Qershor 2008;

grupeve parlamentare të opozitës të udhëheqin një debat të strukturuar që u lejon atyre të kenë një votë mbi një mocion specifik të kërkuar nga ata. Rregullorja e punës siguron procedurë të qartë dhe efikase për interpelanca që do të mund të shfrytëzoheshin me mençuri nga grupet parlamentare të opozitës.³¹ Mangësitë kryesore për funksionim efikas të parlamentit janë pamundësia e një numri të caktuar të deputetëve të kërkojnë interpelancë (Rregullorja e tanishme e punës u lejon vetëm grupeve parlamentare të parashtrojnë interpelancë), grupet parlamentare të opozitës nuk janë mirë të përgatitura dhe mocionet janë të paqarta, debati nuk fokusohet në temë dhe në disa raste mocioni nuk është propozuar për votim nga Kryetari.³²

Komisionet hetuese gjithashtu janë shfrytëzuar shumë rrallë në Kuvend që nga formimi i tij. Deri më tani, janë themeluar vetëm dy komisione hetuese³³ ndërsa vetëm i dyti arriti të përfundoj hetimin e vet dhe të dorëzoj një raport. Komisionet hetuese hasën në shumë vështirësi për shkak të mungesës së bazës ligjore dhe mungesës së Ligjit mbi Komisionet Hetuese. Rregullorja e punës ofroi shumë pak, në lidhje me themelimin dhe funksionimin e komisioneve hetuese³⁴, prandaj anëtarët e komisionit kishin vështirësi në ushtrimin e autoritetit të tyre dhe përmbushjen e mandatit. Ligji mbi Komisionet Hetuese ende është në procedurë, por deputetët duhet të jenë të kujdesshëm kur e shqyrtojnë, amendamentojnë dhe aprovojnë atë duke marrë parasysh rëndësinë e tij për forcimin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit.

Komisionet në Kuvend do të mund të luanin rol të fuqishëm në mbikëqyrjen e aktiviteteve dhe politikave të qeverisë. Komisionet kanë qenë të angazhuara në thirrjen për interpelancë të ministrave përmes dëgjimeve informative dhe monitorimit të implementimit të ligjeve, por akoma mund të përmirësohet cilësia e mbikëqyrjes. Komisionet e Kuvendit janë të mbingarkuara me detyra dhe përgjegjësi duke marrë në konsideratë gjerësinë e fushave që mbulojnë (në disa raste një komision mbulon punën e katër ministrave). Një numër i vogël i personelit mbështetës të komisionit ngarkohet me numër të madh të projektligjeve që rishikohen nga komisioni dhe gjithashtu me dëgjime publike dhe ekspertizë ligjore mbi çështjet e ndryshme. Komisionet gjithashtu duhet pasur një fond të veçantë vjetor³⁵ që do të mund të shfrytëzohej për të angazhuar ekspertë, bërë vizita në teren dhe udhëtime studimore. Prandaj, komisionet e Kuvendit duhet të kenë përkrahje adekuate financiare dhe teknike për të kryer mandatin e tyre në mënyrë demokratike. Duhet të sigurohen së paku tre anëtarë të personelit me orar të plotë për komisionin me rëndësi për tu përpjekur të përfundohen detyrat e komisionit. Komisioneve gjithashtu duhet dhënë të drejtën për një buxhet të veçantë vjetor për të angazhuar më shumë ekspertë në çështje të ndryshme por gjithashtu edhe organizata të cilat do tu japin këshillim falas komisioneve

Megjithatë, për të siguruar zhvillim të mëtejshëm dhe cilësi të mbikëqyrjes, Kuvendi duhet të krijojë dy komisione të reja mbikëqyrëse. Kuvendi ende nuk e ka Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe as Komisionin për Mbikëqyrje të Agjencisë për Inteligjencë. Themelimi dhe funksionimi i këtyre komisioneve është i domosdoshëm për mbikëqyrje të duhur. Për të forcuar funksionin mbikëqyrës të Kuvendit, është e nevojshme të krijohen kushte adekuate për punën e të gjithë deputetëve por në veçanti për grupet parlamentare. Ndikimi i opozitës në komisionet për mbikëqyrje parlamentare mund të mundësohet në shumë mënyra të cilat mund të kombinohen në mënyrat që vijojnë;

- Përmes kryesimit të komisioneve mbikëqyrëse parlamentare nga anëtarët e opozitës,
- Përmes të drejtave të definuara qartë për minoritetet në komisionet e tilla parlamentare (psh. një e treta e anëtarëve mund të bëjnë kërkesë të thërrasin takim apo të marrin të dhëna dhe dokumente nga Qeveria apo nga Ministria dhe organet tjera dhe organizatat e sektorit publik etj.)

³¹ Rregullorja e punës e Kuvendit të Kosovës, Rregulla 25;

³² Interpelanca e kërkuar nga grupi parlamentar ORA për Ministrinë e Arsimit në lidhje me vitet e shkollës fillore, e mbajtur më 25.06.2007;

³³ Komisioni i parë hetues është themeluar mbi trazirat e Marsit 2004 ndërsa i dyti mbi të gjeturat e Zyrës së Auditorit Gjeneral në Kuvend më 2005;

³⁴ Rregullorja e Punës e Kuvendit të Kosovës, Rregulla 50;

³⁵ Në shumicën e parlamenteve, përveç shërbimeve tjera hulumtuese dhe profesionale, komisionet kanë një nëpunës të lartë, zyrtar të lartë ligjor dhe një asistent administrativ. Tani, në Kuvendin e Kosovës një personel i përbërë prej dy zyrtarëve ligjor dhe një asistenti ligjor u ofron mbështetje dy komisioneve të ndryshme;

Rekomandime:

- Kuvendi të amandamentojë (Rregullën 26), duke kufizuar mundësinë e ministrave të shmangin pyetjet;
- Kuvendi të amandamentojë (Rregullën 25) për tu lejuar një numri të caktuar të deputetëve të paraqesin kërkesë për interpelancë;
- Kuvendi të shqyrtojë Ligjin mbi Komisionet Hetuese, për të përmirësuar cilësinë e tij duke bërë amandamentimet e nevojshme dhe ta miratojë atë;
- Kuvendi të sigurojë që komisionet përkrahen me personel adekuat, mbështetje financiare dhe teknike që është e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse (kërkesat minimale për një komision parlamentar një Sekretar, një asistent ekspert dhe një asistent administrativ);

5.2.1. Mbikëqyrja e buxhetit dhe kontrolli i financave publike

“Pushteti i kuletës” (me fjalë tjera, pushteti financiar) i parlamentit është një karakteristikë fundamentale e demokracisë. Pjesa më e madhe e kushtetutave demokratike kërkojnë që Parlamenti duhet të sigurojë që masat mbi të hyrat dhe shpenzimet që ai i autorizon të jenë nga aspekti fiskal të qëndrueshme, tu përshtaten nevojave të popullatës me burimet në dispozicion dhe të zbatohen si duhet dhe në mënyrë efektive.³⁶

Mbikëqyrja parlamentare e buxhetit dhe kontrolli i financave publike bëhen:

- Për të kontrolluar transparencën gjatë shpenzimit të parasë publike;
- Për të siguruar që shpenzimi i buxhetit është në pajtim me ligjin dhe qëllimet e përcaktuara;
- Për të kontrolluar politikën e qeverisë.³⁷

Nën një mbikëqyrje të tillë të buxhetit, dmth Buxhetit të Kosovës- është e rëndësishme që të vihen entitetet tjera legale që financohen nga qeveria (fondi i përkujdesjes shëndetësore, fondi pensional dhe fondet e ngjashme), gjithë sektori publik (institucionet publike, kompanitë publike, shpenzimi publik në nivel të komunave dhe institucioneve në pronësi të komunave).

Brenda Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka rolin kryesor për mbikëqyrjen e implementimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Komisioni pranon raporte periodike nga Ministria e Financave mbi shpenzimet qeveritare por gjithashtu nga institucionet e auditimit. Komisioni është përgjegjës për analizimin e këtyre raporteve dhe prezantimin e të gjeturave para Kuvendit.³⁸ Kuvendi ende nuk ka zhvilluar kapacitetin për të analizuar buxhetin. Shumë legjislatura kanë krijuar zyra për buxhetin të cilat kanë personel profesional që ka ekspertizë për të këshilluar legjislaturën gjatë rishikimit të buxheteve.³⁹

Duke njohur rëndësinë e kontrollit parlamentar, duhet themeluar një Komision special parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen ekzekutimit të buxhetit dhe kontroll të financave tjera publike. Ky komision duhet të kryesohet nga opozita. Arsyetimi për këtë rregullim është që partitë e koalicionit kryesojnë Komisionin e Buxhetit që miraton buxhetin ndërsa opozita përmes raporteve të Auditorit Gjeneral dhe burimeve tjera të informacionit kontrollon ekzekutimin e buxhetit dhe financat tjera publike.

Në të njëjtën kohë, edhe komisionet tjera parlamentare brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre duhet të shqyrtojnë propozim buxhetin dhe draft-propozimin final të buxhetit. Ministrat e qeverisë (gjatë shqyrtimit të draft-propozimit të buxhetit në Kuvend dhe në komisionet tjera relevante parlamentare) duhet prezantuar komisioneve informatat mbi politikën dhe shumën e

³⁶ Instituti Kombëtar Demokratik për Çështje Ndërkombëtare - NDI (2007) “Broshurë mbi mbikëqyrjen Parlamentare”, Prishtinë;

³⁷ Rreth shqyrtimit të draft-buxhetit dhe shpenzimeve të qeverisë, shih: Unioni Ndër-Parlamentar, Parlamenti dhe Demokracia në Shekullin e 21-të. Një Udhëzues për Punë të Mirë, (Gjenevë: Unioni Ndër-Parlamentar, 2006), f. 140;

³⁸ Rregullorja e Punës e Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa, Rregulla 51;

³⁹ Komentet e marra gjatë një takimi me një anëtar të Komisionit për Buxhet dhe Financa, i mbajtur më 4 Qershor 2008;

nevojshme për financim për një fushë të caktuar dhe se si do të arrihet kjo. Në fund të çdo viti buxhetor, Ministrat duhet të sqarojnë për çfarë qëllimi janë shpenzuar mjetet buxhetore dhe deri në ç'shikallë janë arritur qëllimet e secilës politikë.

Është e nevojshme të definohet qartë niveli i kontrollit dhe të shikohet ligjshmëria, destinimi dhe arsyeshmëria e shpenzimeve dhe gjithashtu rregullsia e raporteve financiare bazuar në raportet e Institucionit të Auditorit Suprem (IAS) dmth Zyrës së Auditorit Gjeneral dhe pajtueshmëria me ligjin relevant. Ky organ mbikëqyrës i pavarur do të raportojë Kuvendit. Në këtë kontekst, puna e komisionit Parlamentar për mbikëqyrje të financave publike bazohet në raportet e këtij organi profesional i cili është “krahu i djathtë” i parlamentit.

5.2.2. Komisionet për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP)

Angazhimi parlamentar rreth buxhetit normalisht ka disa faza. Së pari, parlamenti voton buxhetin e propozuar të paraqitur nga qeveria, pastaj monitoron ekzekutimin e buxhetit dhe në fund, parlamenti duhet të shqyrtojë nëse implementimi i buxhetit u bë në pajtim me dëshirat e veta. Auditimi i librave të mbajtjes së llogarisë zakonisht është kryer nga një organ i ndryshëm nga legjislatura, në disa raste një gjyq apo një auditor gjeneral. Por është parlamenti ai që është i ngarkuar me shqyrtimin e rezultateve të një auditimi të tillë. Përderisa disa legjislatura nuk kanë një komision të caktuar që kryen këtë funksion, shumë legjislatura kanë formuar Komisionet për Mbikëqyrjen e Financave Publike për këtë qëllim. Tani është një trend global drejt hapjes më të madhe sa i përket fondeve të qeverisë.⁴⁰ Kjo bazohet në një besim që praktikatat transparente buxhetore mund të sigurojnë që fondet e shtetit për qëllime publike të shpenzohen siç është premtuar nga qeveria dhe të sigurohet që janë arritur përfitimet maksimale nga ai shpenzim. Një komponent thelbësor e sistemit transparent të alokimit të burimeve është sigurimi i paprekshmërisë së buxhetit publik përmes një procesi të auditimit, dhe shqyrtimi i kujdesshëm i rezultateve të tij nga përfaqësuesit e popullit në parlament. Reformat në Britani të Madhe më 1861 sollën krijimin e KMFP -ke dhe shumë vende tjera të Komonuelit-it ndoqën këtë shembull nga ajo kohë. Fakti historik që KMFP konsiderohet të jetë një nga komisionet parlamentare më të vjetra nga të gjitha tregon që rëndësia e tij si organ legjislativ për mbikëqyrje financiare dhe shqyrtim të kujdesshëm është njohur para një kohe të gjatë.

Rregullorja e punës së parlamentit që vlen për të gjitha komisionet vlen edhe për KMFP, deri sa të bëhen përjashtime apo plotësime të veçanta. Përgjithësisht, është detyrë primare e KMFP të shqyrtojë raportet e auditorit gjeneral. Por komisioni dallon nga shumica e komisioneve tjera në kuptimin që ai privohet nga të bërit pyetje për mençurinë e politikës që informon mbi shpenzimin publik. Në vend të kësaj, ai kërkohet të hetojë nëse shpenzimi ishte në pajtim me qëllimet e legjislaturës dhe standardet e pritura dhe gjithashtu nëse është kryer puna e caktuar për paratë e shpenzuara. Funksionet e tij kryesore janë që të shoh nëse paratë publike harxhohen për qëllimet që janë të dhëna nga Parlamenti.

Marrëdhënia ndërmjet parlamentit dhe institucionit të auditimit ndryshon varësisht nga sistemet. Në traditën e Uestminster-it, KMFP është dëgjuesi kryesor i auditorit gjeneral dhe është esenciale që ruhet një marrëdhënie e ngrohtë ndërmjet këtyre të dyve. Përderisa KMFP pret një raport auditimi të kualitetit të lartë, auditori gjeneral në anën tjetër kërkon një KMFP efektiv për të siguruar që departamentet marrin seriozisht rezultatet e auditimit. Kjo varësi e ndërsjellë ekziston që nga koha kur auditori gjeneral është bërë, me statut, zyrtar i parlamentit. Të gjitha raportet e auditorit gjeneral i adresohen parlamentit, dhe auditori gjeneral apo një përfaqësues ndjek mbledhjet e KMFP. Në disa raste, KMFP mund të kërkojë auditorit gjeneral të bëjë një hetim specifik dhe auditori gjeneral nuk ka liri veprimi pra duhet ta bëjë këtë.⁴¹ Kohët e fundit, institucionet e auditimit gjithashtu kanë qenë të prira të zhvillojnë më shumë një funksion këshillues ad hoc kur legjislatura kërkon këshillim apo komente mbi çështje specifike që janë në

⁴⁰ Banka Botërore (2002), Forcimi i Mbikëqyrjes nga Legjislatura, Shën. kryesore, Numër 74;

⁴¹ Stapenhurst, Rick (2004) Qeverisja e mirë, mbikëqyrja parlamentare dhe përgjegjësia financiare. Shqyrtimi Parlamentar i Buxhetit. Instituti i Bankës Botërore;

shqyrtim. Në rast të mosekzistimit apo mungesës së kapacitetit hulumtues të legjislaturës rritet mundësia për më shumë prani në parlament të analizave të ekspertëve të pavarur.⁴²

Përmbajtja e saktë e punës së KMFP varet shumë nga raportet që ai merr nga institucioni i auditimit. Zyra e auditorit gjeneral është burimi primar në dispozicion të komisioneve dhe shoqëron punën e KMFP në bazë të vazhdueshme. Në disa raste, Ministria e Financave cakton zyrtarët që ndjekin dhe përkrahin mbledhjet e komisionit. Një përkrahje e tillë mund të nënkuptojë edhe mundësinë se duhet përgjigjur pyetjeve të anëtarëve të komisionit.

5.2.3. Praktikak më të mira për funksionim të Komisioneve për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Në shumicën e parlamenteve dhe siç duket të jetë rasti në shumicën e komisioneve tjera, raporti i anëtarëve të qeverisë dhe opozitës pasqyron edhe raportin në Kuvend. Është një traditë jetëgjatë në shumë parlamente që kryesuesi i KMFP duhet të jetë një anëtar i opozitës. Kryesuesi duhet të sigurojë funksionim të qetë dhe efikas të komisionit. Në veçanti, kryesuesit e KMFP janë përgjegjës për caktimin e rendit të ditës së komisionit, zakonisht në konsultim me komisionin dhe auditorin gjeneral. Tradita në shumë parlamente favorizon unanimitetin për vendimet e KMFP, por në raste specifike raportet e KMFP mund të përmbajnë pamjen e pakicës që shpreh mospajtim me përmbajtjen e raportit. Megjithatë, anëtarët e komisionit duhet të orvaten të arrijnë konsensus sepse ai forcon efektin e raportit. Në parim, takimet e KMFP dhe dëgjimet janë të hapura për medie dhe publikun e gjerë

Mekanizmi kryesor për shqyrtimin e raporteve të auditimit është dëgjimi në të cilin dëshmitarët thirren para komisionit që të përgjigjen në pyetjet e anëtarëve mbi çështjet e ngritura kritike. KMFP duhet të planifikojë programin e vet kujdesëshëm në konsultim me auditorin gjeneral ashtu që lëshimi i raporteve të sinkronizohet me dëgjimet parlamentare. Anëtarëve të komisionit duhet dhënë rastin tu bëjnë pyetje dëshmitarëve. Në disa raste, kufizimet kohore zbatohen në të drejtën e secilit anëtar të bëjë pyetje. Në Britani, për shembull, KMFP i Parlamentit i jep kryesuesit në fillim të seancës 30 minuta për pyetje. Më vonë, secili anëtar i zakonshëm i komisionit nuk ka më shumë se 15 minuta për të bërë pyetje.

Sapo të jenë përfunduar dëgjimet dhe materialet të jenë mbledhur, është zakonisht përgjegjësi e kryesuesit të KMFP të hartojë një raport në bashkëpunim të ngushtë me nëpunësin e komisionit. Draft-raporti debatohet në KMFP ku mund të propozohen, pranohen apo refuzohen ndryshimet e nevojshme. Raportet e KMFP zakonisht debatohen dhe miratohen gjatë seancave plenare. Në shumicën e parlamenteve, raportet e KMFP janë të hapura për medie dhe publik. Në anën tjetër, ekziston një praktikë që shumica e raporteve të KMFP ndiqen nga një reagim zyrtar i qeverisë brenda një periudhe të caktuar kohore. Për të siguruar që shqetësimet e veçanta të KMFP janë adresuar, në disa parlamente KMFP vazhdon kërkimin e raporteve periodike për të vlerësuar progresin dhe implementimin e rekomandimeve të veta.

Deri më tani, roli i KMFP në Kuvendin e Kosovës është ushtruar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa i cili është i tejngarkuar nga numri i madh i projektligjeve në procedurë, analizimi i implikimeve buxhetore të çdo projektligji të paraqitur në Kuvend dhe përgatitja e buxhetit të parlamentit. Duke pasur parasysh mungesën e kohës dhe personelit të kualifikuar, Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk ishte në gjendje të ushtrojë me efikasitet rolin e vet mbikëqyrës as në shqyrtimin e raporteve tremujore të qeverisë mbi shpenzimet e as rreth raporteve të auditimit të bëra nga Zyra e Auditorit Gjeneral. Gjithashtu, duke pasur parasysh se Komisioni për Buxhet dhe Financa kryesohet nga një anëtar i partive qeverisëse që e kanë shumicën e anëtarëve, duket se ka një shkallë të ultë të vullnetit dhe interesit politik për forcimin e funksionit mbikëqyrës.⁴³

Një studim i kryer në vitin 2007 nga NDI, tregoi se mbi 40% të deputetëve besojnë që Kuvendi nuk ka mjetet dhe kapacitetet e nevojshme për të mbikëqyrur shpenzimet buxhetore. Nevoja për themelimin e KMFP është ngritur nga NDI më 2006 tek ish anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe

⁴² Wehner, Joachim (2002) Praktikak më të mira të Komisioneve për Mbikëqyrjen e Financave Publike , Kejptaun;

⁴³ Komentet e bëra nga një anëtar i opozitës i Komisionit për Buxhet dhe Financa gjatë takimeve të mbajtura më 2 Qershor 2008;

Financa, por në atë kohë, partitë e koalicionit nuk treguan vullnetin dhe interesin për formimin e KMFP. Megjithatë, formimi i KMFP është ngritur në kohë të fundit gjatë një debati dhe përgatitjes për hartimin e Rregullores së re, kryesisht nga organizatat ndërkombëtare që përkrahin Kuvendin. Sapo të jetë formuar, duhet bërë shumë për të pasur një Komision për Llogaridhënie Publike që është i organizuar dhe efikas.

Rekomandime:

- Kuvendi i Kosovës duhet të formojë KMFP, si komision i ndarë funksional
- Autoriteti i KMFP duhet definuar në mënyrë specifike në Rregulloren e Punës
- Duket krijuar dhe mbajtur një raport miqësor mes KMFP dhe Zyrën e Auditorit Gjeneral
- Sekretariati i Kuvendit duhet të sigurojë që KMFP të ketë burime të mjaftueshme

5.2.4. Mbikëqyrja Parlamentare e Agjencisë për Inteligjencë dhe Siguri

Në seancën plenare të mbajtur më 14 Shtator 2006, Kuvendi i Kosovës miratoi propozimin e ish-Komisionit për Gatishmëri Emergjente që të transformojë dhe riemëroj këtë organ parlamentar si Komision mbi Sigurinë. Me atë rast, Kuvendi miratoi kushtet e përgjithshme për formimin e komisionit të ri duke i dhënë atij kompetenca mbikëqyrëse gjithëpërfshirëse mbi Policinë, Shërbimin e Inteligjencës dhe institucionet tjera të sigurisë.

Në mandatin e tanishëm të Kuvendit të Kosovës, ky komision është riemëruar si Komisioni mbi Çështjet e Brendshme dhe Sigurinë me mandat të këshillojë dhe jap rekomandime Kuvendit mbi legjislacionin, vendimet dhe praktikën parlamentare që lidhen me sigurinë e popullatës dhe përdorimin e forcës nga institucionet relevante të sigurisë.⁴⁴

Ky zhvillim i shpejtë në Komisionin mbi Çështjet e Brendshme dhe Sigurinë është aprovuar që të reflektojë zhvillimet evoluese politike në Kosovë. Kjo gjithashtu mund të shihet si një iniciativë që i jep mundësi Kuvendit të marrë mbi vete kapacitetin mbikëqyrës mbi çështjet e lidhura me sigurinë. Megjithatë, krahas planeve për të krijuar shpejt Forcën e Sigurisë së Kosovës me Ministrinë e vet dhe gjithashtu Shërbimet e Inteligjencës, është thelbësisht e rëndësishme që Kuvendi të ushtrojë funksionet e veta mbikëqyrëse me qëllim që të sigurojë kontroll demokratik mbi mekanizmat e sigurisë⁴⁵ Veç kësaj, nën-komisionet për inteligjencë duhet të përcjellin kujdesshëm krijimin e Agjencisë për Inteligjencë.

Rekomandime:

- Kërkoni Kuvendit të shpejtoj krijimin e Komisionit mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Nën-Komisionit për Inteligjencë ashtu që të jepet kohë e mjaftueshme për ndërtim institucional të mekanizmave mbikëqyrës në këta sektorë;
- Siguroni që Komisioni i ri mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës të udhëhiqet nga një anëtar i opozitës, e cila do të ngrisë mbikëqyrjen demokratike, transparencën dhe përgjegjësinë në pajtueshmëri me standardet mbi të drejtat njerëzore të pranuar ndërkombëtarisht.

5.2.5. Bashkëpunimi me institucionet e tjera të pavarura

Deputetët kanë mundësi të formojnë institucione jashtë legjislativës-sikur Ombudspersoni, Auditori Gjeneral dhe Agjencia Anti-korrupsion-për ti ndihmuar ata gjatë procesit të mbikëqyrjes legjislativë. Puna e tyre liron Deputetët nga disa ngarkesa të mbikëqyrjes, shumica e të cilave kërkon shqyrtim të vazhdueshëm dhe kujdes të madh deri në detaje. Në këtë kuptim, ato mund të jenë burim i dobishëm dhe kredibil informatash.

Shqyrtimi i detajuar i raporteve të institucioneve që sipas ligjit obligohen të raportojnë Kuvendit dmth komisioneve të tij parlamentare dhe në seanca plenare është i rëndësishëm për transparencën dhe punën ligjore të këtyre organeve. Në lidhje me këtë, parlamenti mund të reagojë me

⁴⁴ Për më shumë informata shih www.assembly-kosovo.org;

⁴⁵ Për informata gjithëpërfshirëse mbi çështjet e kontrollit demokratik mbi forcat e armatosura ju lutem referoju DCAF (2003) "Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë-Parimet, Mekanizmat dhe Praktikën", Gjenevë;

ndryshim dhe miratim të zgjidhjeve të reja ligjore dhe/apo rekomandime; mund të përmirësojë punën e këtyre institucioneve dhe madje punën e degës së ekzekutivit dhe gjyqësorit brenda kornizës së ligjit të aplikueshëm.⁴⁶

Një nga masat anti-korrupsion më të rëndësishme është organizimi i punës së organeve që parandalojnë konfliktin e interesit tek personat që mbajnë pozita publike në nivel vendi dhe në pozita më të larta në komuna. Puna sistematike në këtë fushë dhe rezultatet e kësaj pune mund të konsiderohen si përpjekje anti-korrupsion e gjithë shoqërisë.

Në këtë aspekt, është e rëndësishme që deklarimi i pasurisë së zyrtarëve dhe kontrolli i atij raporti të bëhet gjatë kohës që personi mban pozitën e tij/saj dhe pas një periudhe të caktuar kohore pasi personi ta ketë lënë pozitën. Gjithashtu, është e rëndësishme të caktohen dhe kryhen aktivitetet e kontrollit mbi zyrtarët publik që synojnë përfitime financiare të cilat nën rrethana të caktuara lejohen paralel me pozitën e tyre.

Është në interesin e të gjithë qytetarëve që Kuvendi të luaj një rol më vendimtar në strategjinë anti-korrupsion. Në lidhje me këtë, Kuvendi duhet të inkurajojë miratimin e një platforme të përgjithshme politike (në formë rezolute), që synon koordinimin e përpjekjeve dhe aktivitetëve të të gjitha organeve relevante kundër korrupsionit dhe të shihet mundësia e formimit të një organi të pavarur për të monitoruar vazhdimisht situatën në këtë fushë.

Rekomandime:

- Të definohet qartë në Rregulloren e Punës së Parlamentit raportimi i Institucioneve të Pavarura në Kuvend;

5.3. Funkzioni përfaqësues

Përfaqësimi është i një rëndësisë primare për funksionim demokratik të organit legjislativ. Një legjislaturë që nuk përfaqëson qytetarët dhe nuk është përgjegjëse para tyre cenon natyrën demokratike të atij vendi. “Demokracia mund të realizohet vetëm atëherë kur ligjvënësit kanë vullnet, aftësi dhe informata për të marrë vendime që pasqyrojnë interesat dhe nevojat e shoqërisë. Gjithashtu, qytetarët duhet pasur vullnetin, aftësinë dhe informatat për t’i transmetuar ligjvënësve, nevojat dhe interesat e tyre, për të vlerësuar performancën e legjislatorëve dhe partive të tyre dhe për të shpërblyer apo sanksionuar veprimet e tyre përmes votimit në zgjedhje”.⁴⁷

Zakonisht, tri kritere merren parasysh gjatë vlerësimit të funksionit përfaqësues të legjislaturës:

1. Përcjellja e punimeve të Kuvendit nga qytetarët;
2. Qasja e qytetarëve në informata të sakta dhe me kohë rreth punimeve të Kuvendit;
3. Bashkëveprimi i qytetarëve me anëtarët e Kuvendit (puna me qytetarë);

5.3.1. Përcjellja e punimeve të Kuvendit nga qytetarët

Qytetarët e Kosovës mund të përcjellin seancën plenare përmes transmetimit të drejtpërdrejtë të TV Kombëtar Publik (RTK). Nëse seancat vazhdojnë pas orës 17:00, TV publik ndërpre transmetimin e vet dhe vazhdon me skemën e vet të zakonshme programore. Një kanal i veçantë televiziv që do të transmetonte seancat parlamentare nuk është sot një zgjidhje shumë realiste në Kosovë, por një kanal i dytë televiziv i transmetuesit kombëtar që, në mes tjerash, do të mbulonte punën e Kuvendit është tash për tash zgjidhja më e mirë. Zgjidhja më e lirë do të ishte paraqitja e punës drejtpërdrejtë me video përmes internetit por dikush mund të kundërshtojë këtë me arsyen se pak kosovarë kanë qasje në internet. Mbledhjet e komisionit nuk transmetohen kurrë drejtpërdrejtë dhe janë mbuluar dobët nga gazetarët e akredituar në Kuvend.

⁴⁶ Institucionet e pavarura në Kosovë, si në demokracitë tjera, janë organe të pavarura që kryejnë funksionet mbikëqyrëse dhe rregullative. Këto mund të ndahen në dy lloje të organeve: 1) institucione të qeverisjes së mirë, të pavarura dhe mbi të drejtat njerëzore të cilat kryejnë funksione mbikëqyrëse mbi qeverinë dhe zakonisht nuk kanë burime vetjake të rëndësishme; dhe 2) agjencitë dhe rregullatorët e pavarur të cilët kryejnë funksion rregullator ose licencues dhe shpesh mbledhin mjete materiale;

⁴⁷ “Manual i USAID-it mbi forcimin e legjislativit”, (2000) Qendra për Demokraci dhe Qeverisje, Uashington DC;

Kur qytetarët shprehin interesim të ndjekin punën plenare apo mbledhjet e komisioneve nga brenda ndërtesës, ata duhet paraqitur një kërkesë shërbimit të Kuvendit. Ka shumë të ngjarë që kjo të hidhet poshtë për shkak të hapësirës së kufizuar në “galeri-pjesën për mysafirë”, e cila nganjëherë është plot me përfaqësues të zyrave të ndryshme që janë në Prishtinë dhe gjithashtu përfaqësues organizatash që mbështesin punën e Kuvendit. Situata sa i përket mbledhjeve të komisionit është madje edhe më e keqe. Ato zakonisht mbahen në dhomën e konferencave dhe nuk ka hapësirë për publik.

Publiku i gjerë zakonisht informohet mbi seancën e ardhshme plenare menjëherë pas takimit të Kryesisë, kur Kuvendi paraqet konkluzionet kryesore të takimit. Sa i përket mbledhjes së Komisionit, vendi i vetëm për këtë lloj informacioni është në faqen zyrtare të Internetit të Kuvendit ku gjithashtu mund të merret rendin i ditës së mbledhjes.

Një shembull tjetër i bashkëveprimit me qytetarë, e ashtuquajtura “Java e Kuvendit” është organizuar për herë të parë në qershor të vitit 2007 dhe përsëri do të organizohet në shtator të vitit 2008. Gjatë këtyre javëve, grupe të deputetëve vizitojnë rajonet e ndryshme në Kosovë dhe takohen me qytetarë. Ekipi vlerësues beson se organizimi i një ngjarjeje të tillë, njëherë në vit, mezi mund të konsiderohet si aktivitet bashkëveprues dhe propozon ngjarje më të shpeshta (çdo të dytin muaj do të ishte më e preferueshme).

Kuvendi i Kosovës gjithashtu ka nevojë të hapë një “Qendër për Vizitorë” ku qytetarët mund të njihen më shumë me punën e Kuvendit, historikun e tij. Zyra për Marrëdhënie me Publikun duhet të jetë përgjegjëse për këtë seksion.

Rekomandime:

- Vendosni procedura më të lehta ndaj kërkesave të qytetarëve për të ndjekur seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve;
- Organizoni “Javën e Kuvendit” më shpesh dhe në mënyrë më të rregullt. Një ngjarje në tre muaj do të ishte pikënisje e mirë;
- Kuvendi i Kosovës duhet të hapë “Qendrën për Vizitorë” që do t’u shërbente vizitorëve të jashtëm gjatë vizitës në ndërtesën e Kuvendit ku do të mësonin më shumë mbi Kuvendin, historikun e tij etj.

5.3.2. Qasja e qytetarëve në informata të sakta dhe me kohë

Qytetarët informohen mbi zhvillimet në Kuvend përmes raporteve të stacioneve televizive dhe gazetave ditore. Nëse janë të interesuar në informata më të detajuara, ata mund të kontrollojnë faqen zyrtare të internetit të Kuvendit ku gjendet një pasqyrë e shkurtër e seancës plenare dhe takimit të komisionit në ditën e njëjtë. Në faqen zyrtare të internetit gjithashtu mund të gjenden ligjet e miratuara nga Kuvendi dhe ato që tanimë janë shpallur.

Transkriptet nga seancat plenare sapo kanë filluar të jenë në dispozicion për publikun, megjithëse me një vonesë tri javëshe. Publikimi i votimit ende është duke hasur në vështirësi teknike, pavarësisht vullnetit politik të udhëheqjes së tanishme të Kuvendit për të publikuar rezultatet e votimit dhe votën e deputetëve⁴⁸.

Nuk ekziston një sistem elektronik i përcjelljes së legjislacionit, megjithëse do të mund të inicohej përmes sistemit ekzistues elektronik për menaxhim të dokumenteve (DMS). Ky sistem i mundëson çdo qytetari të përcjellë gjithë legjislacionin nën shqyrtim parlamentar, amandamentet dhe gjithashtu raportet e Komisioneve mbi pjesët specifike të legjislacionit. Ekipi vlerësues rekomandon që Kuvendi të shfrytëzojë sistemin elektronik për përcjellje të legjislacionit në mënyrë që të ngrisë transparencën e seancave parlamentare dhe gjithashtu që të marrë informata nga qytetarët, shoqëria civile dhe akterët tjerë për legjislacionin që është në procedurë parlamentare.⁴⁹

⁴⁸ Në fillim të Seancës Plenare të 15 Shkurtit 2008, Kryetari Krasniqi shpalli publikimin e rezultateve të votimit dhe votave të deputetëve, nga ajo seancë e këtej;

⁴⁹ Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Dokumentim (KODI) & Misioni i OSBE-së në Kosovë (2007) “Shoqëria Civile dhe Procesi Legjislativ në Kosovë - Studim Analitik në Fund të Mandatit të Dytë të Kuvendit të Kosovës, Prishtinë

Kuvendi publikon buletin e tij në bazë periodike (çdo tre muaj) por nevojitet një plan më i mirë i shpërndarjes, pasi ai mund të gjendet vetëm brenda objektit të Kuvendit. Një iniciativë tjetër e mirë erdhi nga Kabineti i ish-kryetarit të Kuvendit pak para se t'ia dorëzojë pozitën kryetarit të ri. Kjo iniciativë rezultoi me publikimin “Udhëzime për anëtarët e rinj të Kuvendit”. Publikimet e tjera kryesisht inicoohen dhe financohen nga organizatat ndërkombëtare që përkrahin punën e Kuvendit. Ekipi vlerësues rekomandon që Kuvendi të caktojë një linjë të veçantë buxhetore për publikimet e ndryshme që synojnë të informojnë publikun e gjerë rreth punës së Kuvendit dhe gjithashtu që synojnë edukimin e qytetarëve mbi procedurat parlamentare dhe për t'i vënë ata në dijeni për të drejtat e tyre si qytetarë të Kosovës që të informohen mbi punën e Kuvendit, dhe çka është më e rëndësishme, të jenë në dijeni mbi legjislacionin dhe rrugën që të japin mendimet e veta.

Rekomandime:

- Udhëheqja e Kuvendit duhet të bëjë përpjekje shtesë që të sigurojë respektimin e vendimit të vet nga koha e fillimit të legjislaturës për publikimin e votimit dhe transkripteve të mbledhjeve me kohë dhe në mënyrë të duhur;
- Vendosni një Sistem Elektronik për Përcjellje të Legjislacionit duke shfrytëzuar sistemin ekzistues elektronik për menaxhim të dokumenteve.
- Caktoni një linjë të veçantë buxhetore për publikimet e ndryshme që synojnë të informojnë publikun e gjerë mbi punën e Kuvendit;

5.3.3. Bashkëveprimi i qytetarëve me ligjvënësit

Në një demokraci parlamentare, deputetët zgjedhen përmes votimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve, prandaj mbajtja e lidhjes me qytetarët është e një rëndësie vitale për karrierën e tyre politike. Sistemet elektorale mund të japin shtytës më të fortë apo më të dobët për komunikim deputet-qytetar përderisa rrethanat tjera inkurajojnë lidhje më të fortë me partitë politike dhe liderët partiak.

Sistemi elektoral në Kosovë me një zonë stimulon lidhjen më të fortë me partinë politike se sa me votuesit. Pavarësisht nga ky fakt, është e nevojshme të gjinden pikat lidhëse, duke respektuar natyrën e shoqërisë në të cilën deputeti jeton dhe ku është i lidhur në mënyrë sistematike me votuesit (në qytetet rajonet apo vendet e tyre ku deputetët tani jetojnë).

Forcimi i lidhjeve ndërmjet përfaqësuesve të zgjedhur dhe qytetarëve të Kosovës është bërë brengë e vërtetë e partive politike në përgjithësi dhe deputetëve në veçanti. Legjislatura e mëparshme kaloi një varg iniciativash të marrura nga disa deputetë për të hapur zyra të takimit me qytetarë, në përpjekje për të mbajtur kontaktin me ta. Që nga hapja e zyrës së parë të kontaktit me qytetarë (nga Znj. Gjylnaze Sylja në nëntor 2005) janë hapur edhe shtatë zyra të tjera⁵⁰. 14 deputetë ishin të përfshirë në tetë zyra të kontaktit me qytetarë në gjithë Kosovën.

Anëtarët e rinj të Kuvendit kanë shprehur iniciativa për zyra të kontaktit me qytetarë. Gjatë muajve të parë të legjislaturës së tretë deputetet Donika Kadaj dhe Myrvete Pantina hapën zyrat e tyre të kontaktit me qytetarë në ndërtesat e kuvendeve komunale⁵¹. Megjithatë, këto zyra nuk gëzojnë kurrfarë përkrahje institucionale nga Kuvendi i Kosovës dhe nuk kanë burime të adresojnë si duhet brengat e qytetarëve që vizitonin këto zyra. Pa adresim të këtyre mangësive, zyrat ekzistuese të kontaktit me qytetarë nuk janë të qëndrueshme.

Ekipi vlerësues identifikoi tri sfida kryesore në angazhimin e deputetëve për kontakt me qytetarë: E para, koha dhe natyra e angazhimeve të tyre në parlament në një datë të caktuar, javë apo muaj. E dyta, deputetëve shpesh u kërkohet të sigurojnë asistencë mbi çështjet jashtë fushëveprimit të mandatit të tyre-psh. kërkesat për punësim dhe asistencë financiare dhe sfida e tretë dhe kryesore është mungesa e përkrahjes institucionale për deputetë.

⁵⁰ Fehmi Mujota (PDK), Berat Luzha (PDK), Bajrush Xhemali (PDK), Safete Hadërgjonaj (PDK), Hajredin Hyseni (PDK), Genc Gorani (ORA) dhe grupi i deputetëve nga Gjakova;

⁵¹ Donika Kadaj hapi zyrën e saj në Komunën e Istogut dhe zyra e Myrvete Pantinës është duke funksionuar në komunën e Vushtrrisë;

Sfida e parë mund të zgjidhet përmes miratimit të një Plani Vjetor të Punës së Kuvendit në fillim të çdo viti, ndërsa e dyta mund të adresohet përmes sqarimeve të deputetëve për qytetarët mbi kufirin e autoriteteve të tyre. Publikimi i llojit sikurse fletëpalosja “Çfarë mund të bëjë anëtari juaj i Kuvendit për ju” mund të jetë shumë i dobishëm. Sfida e tretë kërkon vullnetin politik të udhëheqjes së Kuvendit për të caktuar një linjë të ndarë buxhetore për kontakt me qytetarë për çdo deputet. Është një standard i pranuar gjerësisht për funksionimin e legjislativave demokratike që legjislatura u siguron legjislatorëve burime të mjaftueshme për t’u mundësuar legjislatorëve përbushjen e përgjegjësive të tyre për kontakt me qytetarë, duke përfshirë udhëtimin për dhe nga zonat e tyre elektorale⁵².

Buxheti për Kuvendin duhet të përfshijë disa mjete për marrjen me qira të hapësirave të punës dhe për përkrahje minimale administrative. Do të ishte ideale që çdo deputet të kishte zyrën e tij/e saj në një pjesë të vendit që do të ishte e hapur në një kohë të caktuar dhe për atë publiku do të informohej mirë. Tani, një zgjidhje e tillë është jorealiste për Kosovën por, duke ditur se roli themelor i një deputeti është përfaqësimi i votuesve, është e nevojshme të hidhet hapi fillestar dhe me atë të inicohen dhe stimulohen kontaktet ndërmjet deputetëve dhe qytetarëve.

Rekomandime:

- Të inkurajohen dhe përkrahen deputetët në vendosjen e kontakteve me qytetarë;
- Për tri vitet e ardhme të caktohet një linjë e veçantë buxhetore për kontakt me qytetarë, duke filluar me mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për dhe nga zona elektorale dhe gjatë viteve pasuese duke përfshirë shpenzimet operationale për zyrën për kontakt me qytetarët;
- Të caktohet një ditë e javës për kontakt me qytetarë në Planin Vjetor të Punës së Kuvendit. Në rrethana normale asnjë seancë plenare dhe mbledhje komisioni nuk do të mbahej gjatë asaj dite. Kryesia e Kuvendit duhet të njoftohet për atë ditë.

⁵² Instituti Demokratik Kombëtar, Unioni Ndër-Parlamentar, Asociacioni Parlamentar i Komonuelit-it (2007) “Standardet Minimale Ndërkombëtare për Funksionimin e Legjislativave Demokratike”, Uashington DC;

6. ORGANIZIMI I PUNËS NË KUVEND

Puna e Kuvendit të Kosovës menaxhohet përmes organeve dhe grupeve të ndryshme dhe secila nga to ka përgjegjësitë e veta. Ky kapitull do të analizojë dhe japë rekomandime mbi punën e Kryetarit dhe Kryesisë, Grupeve Parlamentare, Komisioneve Parlamentare, Anëtarëve të Kuvendit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Administratës së Kuvendit.

6.1. Kryetari dhe Kryesia

Është e nevojshme një strukturë më e mirë organizative që do të mundësonte një funksionim më efikas të Kuvendit të Kosovës. Me qëllim të arritjes së atij qëllimi, Kuvendi duhet të përbëhet nga organet që garantojnë zbatimin e kompetencave të veta konform Kushtetutës së vet⁵³. Këto organe janë: Kryetari i Kuvendit, Zëvendës-Kryetarët e Kuvendit, Komisionet Parlamentare, Grupet Parlamentare dhe Sekretari i Përgjithshëm me shërbimin civil. Struktura e tanishme organizative e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës duhet të pësojë ndryshime në mënyrë që të harmonizohet me dispozitat e Kushtetutës së re⁵⁴.

Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit të miratuar në vitin 2005, Kryesia është përgjegjëse për planin vjetor të punës së Kuvendit, përgatitjen e rendit të ditës për seancat plenare në bashkëpunim me shefat e grupeve parlamentare dhe kohëzgjatjen e debateve në çështje të ndryshme.⁵⁵ Sidoqoftë, sipas Kushtetutës së re, kompetencat e Kryesisë do të reduktohen. Kryesia e re do të përbëhet nga Kryetari dhe pesë Zëvendës-Kryetarë ndërsa kompetencat e saj do të zvogëlohen. Si e tillë, do të jetë përgjegjëse vetëm për funksionimin administrativ të Kuvendit.⁵⁶ Megjithatë, deri te zgjedhjet e ardhshme parlamentare Kryesia e tanishme e Kuvendit do të ketë ato kompetenca që janë paraparë sipas mandatit të vet ekzistues.

Duke pasur parasysh se në fillim të mandatit të ardhshëm, Kryesia do të ketë role dhe kompetenca të ndryshme, është e nevojshme që Kryesia e tanishme të transformohet dhe të definohet roli i shefave të grupeve parlamentare në organizimin e përgjithshëm të punës substanciale të Kuvendit. Një nga mënyrat për të adresuar këto ndryshime është krijimi i një organi të ri të Kuvendit që do të mund të emërohej Kolegjiumi i Kuvendit. Rregullorja e punës do ta definonte Kolegjiumin e Kuvendit si organ vendim-marrës që përbëhet nga Kryetari, zëvendës-kryetarët, shefat e Grupeve Parlamentare, Sekretari i Përgjithshëm dhe një përfaqësues nga Qeveria. Përgjegjësitë kryesore të një organi të tillë do të ishin të përgatisë dhe aprovojë orarin vjetor të punës-në rast se nuk bëhet kjo në seancë plenare-dhe të përgatisë planet e nevojshme dy-mujore të punës. Kështu, me përfshirjen e Kolegjiumit, shefat e Grupeve Parlamentare do të kishin më shumë ndikim dhe do të mirrmin më shumë përgjegjësi për një punë efikase në komisione parlamentare dhe seanca plenare.

Aktualisht, shefat e grupeve parlamentare ftohen të marrin pjesë në takimet e Kryesisë por roli i tyre është i kufizuar vetëm në pjesën e takimit ku diskutohet rendi i ditës. Nga praktika aktuale shihet se shefat e grupeve parlamentare më shumë informohen rreth rendit të ditës dhe se pak kanë ndikim në caktimin e agjendës dhe në përgjithësi në procesin e vendimmarrjes. Krijimi i një kolegjiumi të Kryetarit të Kuvendit do t'u mundësonte atyre që të marrin pjesë në këto takime me të drejta të plota.

Kolegjiumet e tilla ekzistojnë në shumicën e parlamenteve demokratike. Takimet zakonisht kryesohen nga Kryetari, ndërsa shefat e Grupeve Parlamentare kanë fuqi të vërtetë gjatë procesit vendim-marrës. Në parlamentin e Belgjikës, kolegjiumi i zgjeruar përbëhet nga Kryetari, dy Zëvendës-kryetarët dhe shefat e të gjitha grupeve parlamentare.⁵⁷ Kolegjiumi shërben për

⁵³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës” në <http://www.kushtetutakosoves.info>

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Rregullorja e Punës e Kuvendit të Kosovës. Rregulla 6.2

⁵⁶ “Kushtetuta e Republikës së Kosovës”. Dispozitat kalimtare. Neni 161.2

⁵⁷ Chambre des Representants, Reglement, October 2003, Brussels, art. 14

konsultime në lidhje me përgatitjen e seancave plenare, temat e mundshme të rendit të ditës, përgatitjen e planeve të punës dhe çështjet e tjera që mund të kenë ndikim në funksionimin e parlamentit.⁵⁸ Në shumicën e parlamenteve, kolegjiunet vendosin në bazë të votimit të shefave të grupeve parlamentare, i cili reflekton numrin e ulëseve që grupi i tyre i ka në parlament. Kryetarët e komisioneve të Kuvendit dhe personat e tjerë të ftuar nga Kryetari mund të ndjekin seancat e Kolegjiunet pa të drejtë votimi.

Rekomandime:

- Gjatë këtij mandati, shefave të grupeve parlamentare duhet dhënë më shumë fuqi në takimet e Kryesisë së tanishme të Kuvendit veçanërisht në lidhje me caktimin e rendit të ditës për seanca;
- Në Rregulloren e re të Punës, funksioni administrativ i Kryesisë së ardhshme duhet të përcaktohet në mënyrë specifike siç parashihet në Kushtetutë;
- Kryesia e ristrukturuar dhe kompetencat e saj të ndryshuara në mandatin e ardhshëm duhet “të hapin rrugën” për formimin e Kolegjiunet duke iu dhënë shefave të grupeve parlamentare një rol më të madh në procesin vendim-marrës.

6.2. Grupet Parlamentare

Në Kuvendin e Kosovës, shumica e deputetëve organizohen në grupe parlamentare të cilat udhëhiqen nga shefat e grupeve parlamentare të cilët i përfaqësojnë ata gjatë procedurave të caktuara të punës së Kuvendit dhe në disa nga organet e tij. Megjithatë, Kryesia e Kuvendit luan aktualisht rolin më të rëndësishëm.

Një nga zbrazëtitë e identifikuar është mungesa e ekspertizës apo mbështetjes administrative që do të zgjidhte problemet dhe interesat specifike të Grupeve Parlamentare. Aktualisht, grupet parlamentare kanë vetëm një asistent administrativ, i cili nuk përmbushë një nga standardet minimale sipas të cilit “grupeve parlamentare duhet t’u sigurohet mbështetje teknike, administrative dhe logjistike. Kjo mbështetje duhet të realizohet përmes një formule transparente për të mos i lejuar avantazhe partive më të mëdha”.⁵⁹

Kjo zbrazëti qartazi pasqyrohet në cilësinë e punës së tyre në procesin legjislativ, në rolin mbikëqyrës dhe madje në planifikimin dhe organizimin e punës së përgjithshme parlamentare. Kjo më shumë bie në sy tek deputetët nga opozita dhe Grupet Parlamentare të opozitës. Duhet vërejtur, megjithatë, që roli i opozitës dhe partnerëve qeverisës të koalicionit nuk ishte përcaktuar qartë deri më tani për shkak të aspiratës së përbashkët për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Por është e nevojshme të krijohen në të ardhmen e afërt kushte të përshtatshme pune për opozitën në pajtim me standardet e demokracisë parlamentare.

Në mënyrë që deputetët të jenë efikas në punë është e nevojshme të përgatitet një plan për mbështetje profesionale dhe administrative. Ky plan gjithashtu është i nevojshëm për Grupet Parlamentare. Veç kësaj, është e nevojshme të sigurohen hapësira të punës në zyrë nga buxheti i Kuvendit. Qëllimi final duhet të jetë të sigurohen mjete baraz me shumën e pagës së një deputeti, që do të përdorshin për angazhimin e ekspertëve apo për ekspertizë financiare (psh. rishikimi i projektligjeve, amandamentet apo mendimet mbi projektligjet).

Çdo Grup Parlamentar duhet të ketë një Sekretar, një asistent eksperti dhe një asistent administrativ. Një asistent eksperti shtesë duhet t’i jepet grupit për çdo pesë deputetë mbi minimumin bazë. Meqë personeli i Grupeve Parlamentare përzgjedhet nga grupi në fjalë, nuk pritset se ata do të jenë politikisht të paanshëm dhe kjo është arsyeja që ata angazhohen vetëm për një mandat Parlamentar, dmth. për kohën që ekzistojnë Grupet Parlamentare. Zgjidhjet e tilla sigurojnë që pas shuarjes së Grupeve Parlamentare të mos ketë personel të rreshtuar politikisht të

⁵⁸ “Rregullorja e Punës e Parlamentit të Bosnjës”, neni 22, “Kolegjiunet i Zgjeruar i Kuvendit”;

⁵⁹ Instituti Kombëtar Demokratik për Çështje Ndërkombëtare (2006) “Drejt Zhvillimit të Standardeve Ndërkombëtare për Legjislaturat Demokratike”, Uashington

punësuar në Kuvend. Ata që punojnë me kontratë të kufizuar kohore duhet të paguhen pak më mirë sesa ata me kontrata pa limit kohor në Administratën Qendrore të Kuvendit.

Partitë politike marrin fonde çdo vit nga buxheti i Kuvendit sipas linjës buxhetore të “Fondit Mbështetës për Demokratizim”. Në mënyrë që të financohen resurset shtesë të lartpërmendura për funksionimin e grupeve parlamentare, duhet ndarë një përqindje më substanciale të mjeteve që partia i merr nga “Fondi Mbështetës për Demokratizim” për grupin parlamentar.

Duke pasur parasysh faktin që paratë për punën e Kuvendit dhe mbështetja për Grupet Parlamentare vjen nga qytetarët e Kosovës, një kujdes i veçantë duhet kushtuar legalitetit, transparencës dhe përgjegjësisë sa i përket mënyrës se si harxhohen buxhetet.

Po ashtu, në mënyrë që të ngritet efikasiteti dhe cilësia e punës së Grupeve Parlamentare është e këshillueshme për secilin nga këto grupe të kenë Rregulloren e vet të punës apo ndonjë akt tjetër rregullator. Ky akt do të definonte çështjet organizative dhe do të përcaktonte kornizën brenda së cilës Grupet Parlamentare do të mund të kryenin punën e tyre, do të qartësonte të drejtat dhe përgjegjësitë e AP-it/anëtarëve të grupit dhe çështjet rreth përkrahjes së ekspertëve si dhe çështjet tjera relevante.

Grupet Parlamentare duhet ta kenë të ndarë kohën për punën e tyre të përbashkët e cila duhet caktuar përmes një orari vjetor.

6.2.1. Grupi joformal i grave

Grupi joformal i grave është grupi i parë i interesit, i themeluar në Kuvendin e Kosovës në korrik të vitit 2005. Aktivitetet e këtij grupi janë të përqendruara kryesisht në analizimin e ligjeve nga aspekti gjinor, monitorimin e ligjeve që ndjeshme ndaj barazisë gjinore, siç është Ligji i Punës apo Ligji mbi Shëndetësinë.

Krijimi i grupeve të tilla joformale duhet të inkurajohet dhe mbështetet nga lidershpi parlamentar, sepse e pasurojnë jetën parlamentare dhe ofrojnë një forum alternative për deputetët që konsiderojnë se nuk janë të përfaqësuar mjaftueshëm në grupet tjera. Siq theksohet në nenin 4.2 të Konventës Ndërkombëtare të Drejtave Civile dhe Politike të njeriut “secili deputet ka të drejtë të përfshihet në grupet formale apo jo formale të deputetëve me të cilët ndan interesin e njëjtë”.

Rekomandime:

- Të përgatitet një plan zhvillimor për mbështetje profesionale dhe administrative për deputetët dhe Grupet Parlamentare me data të përcaktuara të fillimit/mbarimit;
- Të inkurajohen partitë politike të rrisin shumën e mjeteve financiare të marrura nga “Fondi mbështetës për Demokratizim” për punën e grupeve të tyre parlamentare;
- Të definohen rregulla të qarta mbi harxhimin e përgjegjshëm të mjeteve të dedikuara për Grupet Parlamentare dhe të raportohet mbi harxhimin e tyre;
- Të përgatitet një orar vjetor, bazuar në Orarin e Kuvendit dhe punën në Grupet Parlamentare;
- Të hartohet dhe miratohet Rregullore për organizmin e brendshëm dhe funksionimin e grupeve parlamentare.

6.3. Komisionet Parlamentare

Komisionet parlamentare janë organet më të rëndësishme të cilat u mundësojnë legjislativave të kryejnë një numër të madh të funksioneve njëkohësisht. Komisionet luajnë rol kyç në proceset demokratike përmes shqyrtimit të projektligjeve nen për nen, konsultimeve me publikun e gjerë, thirrjen e Ministrave dhe zyrtarëve të Qeverisë për të raportuar për punën e tyre, dhe angazhimin e ekspertëve të ndryshëm gjatë shqyrtimit të legjislacionit. Edhe pse kompetencat e komisioneve

dallojnë nga një parlament në tjetrin, në përgjithësi trendet tregojnë se komisionet ofrojnë një ambient më të përshtatshëm për zhvillimin e punimeve në krahasim me seancat plenare.

Rregullorja e Punës e Kuvendit parasheh themelimin e komisioneve kryesore dhe komisioneve funksionale, të cilat merren me shqyrtimin e projektligjeve dhe rekomandimin e amendamenteve të nevojshme. Në Kuvendin e Kosovës funksionojnë dy komisione kryesore, Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.⁶⁰ Me kërkesë të 1/3 së deputetëve, Kuvendi mund të themelojë edhe komisione të përkohshme me të gjitha kompetencat e njëjta me komisionet funksionale për të hetuar një çështje specifike. Me qëllim të ballafaqimit me ngarkesën e madhe të punës, Komisionet themelojnë edhe nën-komisione apo grupeve punues të cilat për punën e tyre i raportojnë komisionit. Përbërja e komisioneve parlamentare reflekton proporcionalisht fuqinë e grupeve parlamentare.

Ndryshimet e fundit në strukturën e komisioneve rezultuan me krijimin e një komisioni të përhershëm për Rregulloren e Punës. Ky komision ka mandatin për hartimin e Rregullores së re të Punës dhe njëkohësisht monitorimin e zbatimit të Rregullores në praktikë. Aktualisht, hartimi i Rregullores së re është në fazën finale dhe nga diskutimet e zhvilluara pritet edhe krijimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencionit të Inteligjencës dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, me qëllim të rritjes së kapacitetit të Kuvendit për të ushtruar funksionin mbikëqyrës dhe për të kërkuar llogaridhënie nga Qeveria.

Me qëllim të grumbullimit të informacioneve për çështje nën diskutim, komisionet organizojnë dëgjime publike, gjatë të cilave ftohen ekspertë, organizata joqeveritare, grupe të interesit dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile. Në këtë kontekst, OJQ-të mund të ofrojnë informacione të vlefshme në shqyrtimin e projektligjeve dhe ushtrimin e funksionit mbikëqyrës. Dëgjimet publike zakonisht karakterizohen me diskutime që kanë për qëllim sqarimin e çështjeve nën diskutim me qëllim të rritjes së kualitetit të projektligjeve që janë në shqyrtim të komisioneve. Disa nga këto dëgjime publike nuk kanë arritur qëllimin e dëshiruar për shkak të pjesëmarrjes së vogël të organizatave joqeveritare, ekspertëve apo publikut të gjerë dhe se vetëm një numër i vogël i rekomandimeve të tyre janë transformuar në amendamente.⁶¹ Disa nga komisionet partnere të NDI janë angazhuar në krijimin e bazës së të dhënave të OJQ-ve dhe ekspertëve, me qëllim të identifikimit dhe thirrjes së personave dhe organizatave të duhura gjatë dëgjimeve publike legislative.

Komisionet kanë kompetenca për të monitoruar implementimin e ligjeve. Komisionet realizojnë vizita në terren tek institucionet të cilat operojnë bazuar në ligjin në fjalë, me ç'rast njoftohen në lidhje me pengesat praktike që pengojnë zbatueshmërinë e mirëfilltë të ligjit. Komisionet organizojnë edhe dëgjime informative ku ftojnë ministrat apo zyrtarët tjerë të ministrisë për të kërkuar sqarime në lidhje me zbatimin e ligjit.⁶² Pasi të kenë mbledhur informacionet e nevojshme, anëtarët e komisionit përgatisin raportin i cili pasqyron gjendjen reale të zbatimit të ligjit, pengesat kryesore që janë hasur dhe rekomandimet që duhet të ndërmerren nga organet ekzekutive për tejkalimin e tyre. Raporti përfundimtar i miratuar në Komision pastaj dorëzohet në Kuvend ku gjatë seancave plenare shqyrtohet dhe miratohet. Raporti bashkë me rekomandimet i dorëzohet qeverisë e cila pas një kohe të caktuar duhet të raportojë në lidhje me progresin e arritur.

Zakonisht, komisionet zhvillojnë takimet e rregullta dy herë në muaj. Takimet udhëhiqen nga Kryetari i Komisionit i cili përcakton rendin e ditës, të cilin duhet t'ua komunikojë anëtarëve të tjerë së paku katër ditë pune para zhvillimit të takimit. Megjithatë, disa komisione si ai për Buxhet dhe Financa takohen më shpesh me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi të shumta që u takojnë në kuadër të fushëveprimit të tyre. Rezultatet e punës së tyre, komisionet i raportojnë më shkrim në Kuvend dhe mund t'i plotësojnë ato edhe me gojë gjatë seancave. Në parim, takimet e komisioneve janë të hapura me përjashtim të rasteve kur diskutohen çështje të

⁶⁰ Rregullorja e Punës e Kuvendit të Kosovës. Rregulla 48

⁶¹ Instituti Demokratik i Kosovës. Flete-notimet për Kuvendin e Kosovës. Prishtinë. Janar 2007.

⁶² Rregullorja e Punës e Kuvendit të Kosovës. Rregulla 53

sigurisë apo ndonjë çështje tjetër me shumë rëndësi.⁶³ Si rregull, një përfaqësues nga Ministritë duhet të ftohet të marrë pjesë në takimet e komisionit, e veçanërisht në rastet kur diskutohet ndonjë projektligj që është sponsoruar nga ata. Fatkeqësisht, kjo praktikë ende nuk funksionon si duhet dhe është ngritur si problem në disa komisione.

Në fillim të vitit, të gjitha komisionet hartojnë dhe miratojnë planet e punës me qëllim të organizimit më të mirë të punës dhe rritjes së efikasitetit. Në përgjithësi planet e punës reflektojnë programin e ministrive që mbulojnë komisionet dhe renditjen kronologjike të aktiviteteve të komisionit. Planet e punës mund të përmirësohen duke përfshirë afatet kohore për organizimin e dëgjimeve publike legjislative, dëgjimeve informative dhe aktiviteteve tjera shtesë. Dinamika e takimeve të komisionit konsiderohet e kënaqshme. Rregullorja e re e punës pritet tu mundësojë Komisionet të hartojnë dhe miratojnë Rregulloret e brendshme të Punës, të cilat natyrisht do të jenë në përputhje të plotë me Rregulloren e Punës të Kuvendit.

Komisionet janë të stërngarkuara kur duhet se disa prej tyre mbulojnë deri në katër ministri të ndryshme. Numri i vogël i personelit mbështetës për komisionet nuk mund të mbulojnë punën rreth numrit të madh të projektligjeve në procedurë, organizimin e dëgjimeve publike dhe aktiviteteve tjera në komision. Një ekip prej dy zyrtarëve ligjorë dhe një asistenti administrativ ofron mbështetje për dy komisione të ndryshme parlamentare. Komisioneve u nevojitet edhe një buxhet special të cilin do të mund ta shfrytëzonin për të angazhuar ekspertë dhe për të organizuar vizita studimore. Së paku nga tre zyrtarë profesional duhet të angazhohen në secilin komision me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisë.

Rekomandime:

- Komisioneve parlamentare duhet siguar hapësira më të mira për punë dhe logjistikë dhe nëse është e mundur një asistent i cili ndihmon kryetarët;
- Të ngritet niveli i transparencës së Kuvendit dhe të zhvillohet një qasje e hapur ndaj organizatave të shoqërisë civile për të rritur rolin mbikëqyrës të komisioneve parlamentare.

6.4. Anëtarët e Kuvendit

Deputetët janë përfaqësuesit e zgjedhur dhe si të tillë ata përfaqësojnë të gjitha kategoritë e qytetarëve. Ata duhet të kenë përkrahje adekuate që mund të sigurohet nga Administrata Qendrore e Kuvendit dhe administrata e Grupeve Parlamentare. Shërbimin e Administratës Qendrore të Kuvendit e përbëjnë ata shërbyes civil që politikisht janë të paanshëm dhe janë të punësuar të përhershëm të cilët kryejnë detyrat për Kuvendin dhe komisionet e tij parlamentare⁶⁴.

Bazuar në konsultimet me deputetë dhe personelin administrativ,⁶⁵ është e qartë se ka përkrahje për profesionalizimin e deputetëve. Puna profesionale e deputetëve nënkupton që profesioni i tyre i vetëm është mandati si deputet prandaj nuk është realiste të pritët nga deputetët të mbajnë detyra apo pozita tjera gjatë mandatit të tyre. Situata e tanishme është e tillë që për disa deputetë postet e tyre si drejtorë, profesorë etj. duken të jenë më të rëndësishme se të qenurit deputet. Probleme të ngjashme paraqiten në rastet kur deputeti njëkohësisht është Ministër në Qeveri. Kjo e fundit do të ndalohet sipas kushtetutës së re.⁶⁶

Në disa parlamente ku deputetët përmbushin mandatin e tyre në mënyrë profesionale, ata mund të kenë punë të dytë. Kjo dispozitë, megjithatë, mund të kufizojë orët shtesë të punës parlamentare në maksimum një të pestën e orëve të përgjithshme të punës. Zgjidhjet e tilla janë bërë në mënyrë që të insistohet në një shkallë më të lartë të përgjegjësisë nga deputetët dhe gjithashtu në një prani më të madhe në mbledhjet e Kuvendit dhe komisioneve parlamentare. Kjo përfshin gjithashtu

⁶³ Rregullorja e Punës e Kuvendit të Kosovës. Rregulla 46

⁶⁴ Kuvendi i Kosovës "Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës", e miratuar më 20 Maj 2005 dhe e amenduar më 1 Qershor 2006, Rregulla 12-15, f. 19-21;

⁶⁵ Intervistat e bëra më 02 Qershor 2008 me Zot. Ibrahim Gashin deputet, Zot. Xhezair Muratin deputet, Zot. Isa Nezirin, Shef i Departamentit të Administratës, Zot. Daut Beqiri, Shef i Departamentit Ligjor;

⁶⁶ "Kushtetuta e Republikës së Kosovës", në <http://www.kushtetutakosoves.info>;

masat ndëshkuese për mosvijueshmëri. Profesionalizimi i të gjithë deputetëve do të mundësonte punë më të përgjegjshme dhe të cilësisë më të lartë, organizim më të mirë dhe, së paku, do të parandalonte konfliktet e mundshme të interesit. Më 2 Nëntor 2007, Kuvendi i Kosovës miratoi Projektligjin mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve. Meqë projektligji nuk është shpallur nga PSSP-ja, në mes tjerash për shkak se nuk ka një pasqyrë të saktë të ndikimit financiar, Projektligji i është kthyer Kuvendit për shqyrtim të mëtejshëm.

Korniza e re kohore për këtë draft-ligj i jep Kuvendit mundësinë të adresojë një numër çështjesh të cilat mendohej të rregulloheshin me këtë draft-ligj, duke përfshirë statusin, imunitetin dhe përfitimet e anëtarëve të Kuvendit dhe gjithashtu papajtueshmërinë e mandatit të Anëtarit me funksionet tjera në sektorin publik dhe privat. Kjo gjithashtu do të jetë një mundësi për ta hartuar këtë ligj të ri në pajtim me ligjet e tjera që tanimë janë në fuqi dhe për të përmirësuar dhe harmonizuar dispozitat e papajtueshme dhe kontradiktore në Ligj. Meqenëse ka vendime të rëndësishme politike që mund të vënë në rrezik, diskutimi rreth kësaj teme duhet të përfshihet gjatë përgatitjes së Rregullores së re të punës së Kuvendit të Kosovës apo të hapen diskutime në disa forume tjera.

Zhvillimi profesional i deputetëve është gjithashtu i rëndësishëm për të mundësuar që Kuvendi të kryej me efikasitet punën e tij. Përgjegjësia kryesore për këtë zhvillim profesional bie mbi partitë politike të cilat propozojnë kandidatët e tyre më të mirë dhe votuesit të cilat sigurojnë mandatin e tyre. Megjithatë, është e mundshme që madje edhe kandidatët që marrin numrin më të madh të votave në rajonet e tyre nuk janë mirë të informuar me punën specifike të Kuvendit.

Pas zgjedhjeve, përkatësisht në fillim të mandatit të ri, deputetët duhet që në kohën më të shkurtër të mundshme të përgatisin veten për një ushtrim më cilësor dhe efikas të funksioneve të tyre. Në këtë fazë është e nevojshme të vizitohet ndërtesa e Kuvendit, administrata e tij, të njoftohen deputetët me Rregulloren e punës së Kuvendit dhe dokumentet tjera relevante, dhe gjithashtu mbi të drejtat dhe obligimet e tyre. Në këtë aspekt, Administrata e Kuvendit dhe deputetët të rizgjedhur mund të japin kontribut të rëndësishëm. Që nga viti 2001 janë mbajtur tri palë zgjedhje parlamentare dhe janë organizuar tri programe orientuese për deputetët të sapozgjedhur. Megjithëse dy programet e para orientuese janë përgatitur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMIK) dhe Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), programi i tretë orientues (Janar-Shkurt 2008) është shënuar me një rol të qartë të Sekretariatit të Kuvendit në zhvillimin e programit dhe organizimin e seancave punuese me anëtarët e rinj të Kuvendit.

Gjatë mandatit të tyre, deputetët duhet të kenë më shumë mundësi për trajnim të mëtejshëm dhe zhvillim të njohurive në pajtim me nevojat e Kuvendit dhe interesat e deputetëve, duke pasur për bazë fushën e tyre të specializimit dhe komisionet parlamentare, anëtarë të së cilave ata janë. Organizimi i seminareve mbi punën parlamentare dhe punën e institucioneve të Bashkimit Evropian, i kurseve të gjuhëve të huaja, kurseve për kompjuter dhe TI, protokoll etj, duhet të përfshihet në listën trajnuese për deputetë. Përkrahja e donatorëve të jashtëm është e rëndësishme por Kuvendi i Kosovës duhet të jetë në gjendje të zhvillojë programe përmes këshillimit me donatorët e jashtëm në mënyrë që të marrë përvojat më të mira nga rajoni dhe nga demokracitë e zhvilluara parlamentare.

Trajnimi i deputetëve duhet bërë përmes një akti të veçantë në të cilin definohen rregullat dhe mjetet e nevojshme.

Rekomandime:

- Deputetët nuk duhet të kenë ndonjë punë tjetër gjatë mandatit të tyre, përveç për një kohë të kufizuar. Në këto raste, limiti kohor për “punën e dytë” të deputetit duhet të jetë në maksimum 1/5 e orëve javore të punës (maksimumi 8 orë në javë apo një ditë e plotë pune);
- Të vazhdohet me organizimin e përgatitjes së deputetëve për punë në Kuvend në fillim të mandatit të tyre;

- Të miratohet një akt i veçantë mbi zhvillimin profesional të deputetëve gjatë mandatit të tyre dhe të ndahen mjetet për këtë qëllim.
- Të rishikohet dhe përmirësohet Draft-Ligji mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve gjatë mandatit të tretë të Kuvendit, duke marrë plotësisht parasysh ndikimin financiar dhe gjithashtu të qartësohen funksionet e deputetëve në sferën publike dhe private.
- Duke filluar nga mandati i ardhshëm, dispozitat e Kushtetutës të cilat thonë që deputetët nuk mund të bëhen Ministra duhet të respektohen.

6.5. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit

Ashtu sikur që ndodh në parlamentet e tjera demokratike, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës që të sigurojë shërbimet e nevojshme mbështetëse të sekretariatit për të gjithë parlamentarët në mënyrë të barabartë. Prandaj është e rëndësishme që Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të mund të veprojë në mënyrë të pavarur dhe të jetë i lirë nga presioni politik në punën e tij. Një nga arritjet e fundit të Kuvendit ka qenë tranzicioni nga legjislatura e dytë në të tretën dhe ndryshimet në pozitën e Kryetarit të Kuvendit ku sigurohej vazhdimësi përmes pranisë dhe shërbimit profesional të Sekretarit të Përgjithshëm. Në të ardhmen gjithashtu do të jetë e rëndësishme që Kryetari dhe të gjitha grupet parlamentare të vazhdojnë të përkrahin punën e një Sekretari të Përgjithshëm profesionist dhe politikisht neutral, shërbyesit civil më të lartë në Kuvend.

Funksionet e Sekretarit të Përgjithshëm definoohen në Kapitullin 2, Neni 7 të Rregullores mbi Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Kosovës, e miratuar nga Kryesia e Kuvendit më 25 Prill 2007⁶⁷ në një përpjekje për të qartësuar në detaje rolin e tij dhe përgjegjësitë dhe marrëdhëniet e tij me Kryetarin e Kuvendit, Shefat e Grupeve Parlamentare, liderët, kryetarët e komisioneve dhe deputetët⁶⁸.

Roli kryesor i Sekretarit të Përgjithshëm është të menaxhojë administratën e Kuvendit, organizojë dhe menaxhojë shërbimet profesionale, sigurojë shërbime të barabarta dhe vazhdojë zhvillimin e këtyre shërbimeve. Bazuar në rregulloret e brendshme, Sekretarit të Përgjithshëm duhet dhënë përgjegjësitë dhe kompetencat në vijim:

- Të përgatisë draft buxhetin për Kuvendin i cili do të miratohej nga një organ më i lartë;
- Të aprovojë mjetet financiare për punën e Kuvendit dhe Administratës;
- Të përzgjedhë zyrtarët përgjegjës për shërbimet e furnizimit;
- Të nxjerrë rregullore dhe aktet tjera në pajtueshmëri me ligjet;
- Të vendosë mbi angazhimin në punë të të punësuarve në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e Kuvendit;
- Të përgatisë draft-rregulloret që duhet të miratohen më vonë nga një organ më i lartë.

Rekomandime:

- Të krijohet linja të qarta komunikimi ndërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, stafit civil dhe stafit politik;
- Të respektohen plotësisht përgjegjësitë dhe autoriteti i Sekretarit të Përgjithshëm sipas Rregullores mbi Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Kosovës.

⁶⁷ Për më shumë informata shih "Rregullorja mbi Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Kosovës", Prishtinë 2007;

⁶⁸ Kuvendi i Kosovës "Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës", e miratuar më 20 Maj 2005 dhe e amendamentuar më 1 Qershor 2006, Rregulla 56.3. f.52;

6.6. Administrata e Kuvendit

6.6.1 Baza ligjore dhe zhvillimet e fundit

Më 25 prill 2007, Kryesia e Kuvendit të Kosovës, bazuar në Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut 2007/2 lidhur me implementimin e rregullores 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe në pajtueshmëri me rregullën 56.2 të Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut 2001/21, miratoi ‘Rregulloren mbi Statusin e Shërbimit Civil të Kuvendit të Kosovës’, ‘Rregulloren mbi Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Kosovës’, ‘Tabelën e Personelit të Kuvendit të Kosovës’ dhe ‘Listën e niveleve dhe emrave të pozitave të personelit në Kuvend dhe nivelet e pagës së të punësuarve të Kuvendit’.⁶⁹

Një Konzorcium i Paramenteve të Belgjikës, Francës, Gjermanisë dhe Sllovenisë vlerësoi se ajo që njihej si “Pakoja e reformave e shërbimit civil të Kuvendit të Kosovës”⁷⁰ e cila ishte mbështetur nga projekti i AER-it “Përkrahje e Mëtejshme për Kuvendin e Kosovës” paraqet bazën për punën e shërbimit civil të Kuvendit të Kosovës.

Aktualisht, të 157 pozitat në administratën e Kuvendit janë plotësuar. Në veçanti, Divizioni i Protokolit, Mbështetjes për deputetët dhe i Komunikimit është tani plotësisht operacional, ndërsa disa pozita si: Udhëheqës i Divizionit për Standardizim Ligjor, Këshillim Ligjor, Hulumtim, Bibliotekë dhe Arkivë dhe pozitat e Udhëheqësve të Divizioneve tjera janë plotësuar për herë të parë. Në anën tjetër, vlen të përmendet që në mars të vitit 2008, Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit i cili ishte rekrutuar në verë të vitit 2007, braktisi Kuvendin. Kjo paraqet një dobësim të ndjeshëm të kapacitetit të Administratës për tu përballur me efikasitet dhe në mënyrë transparente me çështjet e prokurimit derisa të trajnohet plotësisht anëtari i ri i personelit.

6.6.2 Çështja e kohëzgjatjes së kontratave për të punësuarit permanent

Neni 14 i Rregullores për statusin e Shërbimit Civil të Kuvendit të Kosovës thotë ”kur periudha provuese vlerësohet e kënaqshme, atëherë kandidati në punë provuese emërohet në bazë të përhershme”. Megjithatë, gjatë intervistave me personelin e Kuvendit të Kosovës ata treguan që kontratat e tyre me Kuvendin kanë kohëzgjatje të ndryshme. Duhet thënë se ky është një vendim i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe që Rregulloja e tillë për Statusin e Shërbimit Civil duhet të zbatohet plotësisht.

Një nga problemet e Kuvendit është punësimi i personelit të ri meqë pagat nuk janë shumë atraktive për personelin me kualifikime më të larta. Pagat nuk janë të mjaftueshme të mbulojnë harxhimet elementare dhe shpesh shërbyesit civil detyrohen të gjejnë rrugë alternative të krijimit të të ardhurave. Një numër i madh i njerëzve të kualifikuar shmangin sfidën e punës në administratë publike dhe më parë përzgjedhin punësimin në sektorin privat dhe atë të shoqërisë civile. Mbështetja me ekspertë, administrative dhe teknike për deputetë dhe Grupet Parlamentare është shumë e rëndësishme për cilësinë e punës së Kuvendit. Deputetët kanë nevojë për mbështetje profesionale në mënyrë që të japin kontribut cilësor në procesin legjislativ dhe në mbikëqyrjen e Qeverisë në harmoni me kushtetutën dhe kornizën ekzistuese ligjore. Mbështetja e pamjaftueshme me ekspertë reflektohet në debatet gjatë takimeve të komisioneve dhe seanca parlamentare. Disa deputetëve u mungojnë argumentet dhe propozimet dhe shpesh diskutojnë çështjet që nuk janë në rend të ditës.

6.6.3 “Modeli i kombinuar” për administratën e Kuvendit

Duke parë nevojën për mbështetje adekuate, administrata qendrore në parlamentet e vendeve të Bashkimit Evropian siguron mbështetje profesionale dhe të paanshme për Parlamentin, për deputetët dhe Grupet Parlamentare. Gjithashtu kjo administratë ofron ekspertë dhe mbështetje administrative për kryerjen e funksioneve të deputetëve, përmbushjen e premtimeve të dhëna

⁶⁹Për më shumë shiko procesverbalin e takimit të Kryesisë së Kuvendit: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/proc/proc_0_2007_04_25_al.pdf; Për rregulloret e UNMIK-ut shiko www.unmikonline.org;

⁷⁰ Raporti Final “Përkrahje e Mëtejshme për Kuvendin e Kosovës” (2008), një Projekt i Financuar nga BE dhe i Menaxhuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim, Prishtinë;

gjatë fushatës zgjedhore dhe vizitave të bëra gjatë mandatit. Me fjalë të tjera, administratat në parlamente janë duke u zhvilluar në bazë të të ashtuquajturit “model i kombinuar”. Kjo do të thotë që administrata qendrore, si institucion i përhershëm dhe i paanshëm, kryen detyra profesionale dhe administrative për parlamentin si tërësi, ndërsa shërbimet për Grupet Parlamentare, shërbimet për deputetë kryhen nga ekipet profesionale dhe administrative të interesit të veçantë për një grup të caktuar të deputetëve.

Kuvendi duhet të gjejë një mënyrë për të mundur mbështetjen e deputetëve dhe grupeve parlamentare përmes “modelit të kombinuar” që u përmend më lart. Kjo formë e mbështetjes mund të jetë e organizuar duke u siguruar grupeve parlamentare mjete për angazhimin e ekspertëve me qëllim të zhvillimit të analizave, studimeve, shqyrtimit të projektligjeve etj. Është me rëndësi të theksohet fakti se grupet parlamentare duhet të kenë liri absolute në selektimin e kandidatëve që i konsiderojnë të nevojshëm. Edhe organogarmi aktual i të punësuarve duhet të shqyrtohet duke u fokusuar në rritjen e numrit të pozitive në shërbimet profesionale dhe teknike.

6.6.4 Trupat administrative që kanë nevojë për mbështetje

Në Kuvendin e Kosovës pothuajse të gjithë pajtohen që struktura e tanishme e personelit, numri i personelit, përgatitja e tyre arsimore dhe kushtet tjera të kërkuara për punë (njohja e gjuhëve të huaja, shkathtësia në kompjuter, njohuri mbi institucionet legale të Bashkimit Evropian dhe punën e parlamenteve moderne), nuk plotësojnë nevojat e Kuvendit, d.m.th. nuk ofrojnë mbështetjen e nevojshme për punë normale.⁷¹

Organet përgjegjëse për cilësi të punës dhe funksionimit të Kuvendit janë:

Divizioni për Mbështetje të Komisioneve Parlamentare (në veçanti Sektori që përkrah Komisionin Parlamentar për Integrim në Bashkimin Evropian) është përgjegjës⁷² për dhënien e këshillave ligjore dhe mbështetjes legjislative dhe procedurale për komisionet parlamentare duke përfshirë përgatitjen e raporteve ligjore mbi draft-legjislacionin; dhënien e mbështetjes në përgatitjen e rendit të ditës dhe planit të punës të Komisioneve; përgatitjen e rendit të ditës; shqyrtimin legjislativ-teknik të draft-ligjeve. Ky shërbim, në bashkëpunim me shërbimin përkatës në Qeveri, duhet gjithashtu të inicojë dhe përgatis rregulla të standardizuara për shqyrtim dhe interpretim të ligjeve të Bashkimit Evropian.

Divizioni për Standardizim Ligjor, Këshillim Ligjor, Hululumtim, Bibliotekë dhe Arkiv është përgjegjës për të mbështetur shërbimet që përgatisin legjislacionin gjatë përgatitjes së legjislacionit dhe amendamentimit; standardizim ligjor përmes metodologjisë ligjore, teknike dhe unike; standardizim gjuhësor; harmonizim të legjislacionit me *acquis communautaire* dhe të drejtën ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë. Sektori i hululumtit dhe bibliotekës shqyrton çështje nga fusha të ndryshme, bën analizë, hululumtim krahasues të legjislacionit nga vendet tjera (veçanërisht vendet e Bashkimit Evropian) si dhe shqyrton çështjet që janë të lidhura me statusin dhe punën e deputetëve. Zyra e Dokumentacionit së bashku me Bibliotekën e Kuvendit do të mbështesin punën e deputetëve dhe shfrytëzuesve tjerë të brendshëm rreth çështjeve të sistemit ligjor nacional dhe Evropian si dhe do të mbledhin, shqyrtojnë dhe përgatisin materialin e ndryshëm bibliotekar⁷³.

Divizioni i Teknologjisë Informative është përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e tërë sistemit elektronik të Kuvendit; për furnizim, zhvillim dhe mirëmbajtje të Sistemit Informativ si dhe zhvillon dhe kryen punë profesionale në fushën e TI dhe mbështet procesin legjislativ⁷⁴.

▪ **Seksioni për Media dhe Marrëdhënie me Publikun** është përgjegjës për komunikimin institucional të Kuvendit; raportim dhe publikim të informatave dhe dokumentacionit,

⁷¹ Intervistat e ekipit të bëra me anëtarët e Kryesisë, Shefat e Grupeve Parlamentare, deputetët dhe personelin gjatë vizitës së parë vlerësuese, 2-6 Qershor 2008, Prishtinë;

⁷² Përshkrimi i përgjegjësive të Divizionit për Mbështetje të Komisioneve Parlamentare bëhet në “Rregulloren mbi Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Kosovës”, e miratuar nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës më 25 Prill 2007 në Prishtinë, f. 5;

⁷³ Përshkrimi i përgjegjësive për standardizim ligjor, këshillim ligjor, Hululumtim, Bibliotekë dhe Arkiv bëhet në “Rregulloren mbi Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Kosovës”, e miratuar nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës më 25 Prill 2007 në Prishtinë, f. 5-6;

⁷⁴ Përshkrimi i përgjegjësive të Seksionit për Media dhe Marrëdhënie me Publikun bëhet në “Rregulloren mbi Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Kosovës”, e miratuar nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës më 25 Prill 2007 në Prishtinë, f.7;

deklaratave për shtyp si dhe informatave në lidhje me aktivitetet dhe organizimin e konferencave për shtyp nga organet e Kuvendit si: Kryetari, Kryesia dhe Komisionet Parlamentare; mbajtjen dhe freskimin e faqes së Internetit të Kuvendit; Marrëdhënie me Media, shoqërinë civile dhe qytetarët në mënyrë që të lehtësohet qasja në informata brenda Kuvendit, etj.⁷⁵

Personeli mbështetës i Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian merret me punën që është relevante për komisionin, duke pasur parasysh rolin e vet specifik.

6.6.5 Rekrutimi dhe trajnimi

Në të gjitha divizionet e përmendura më lartë, seksionet dhe sektorët, duhet të fillojë procesi gradual i rekrutimit të personelit shtesë, sipas analizës financiare të paraqitur në këtë Raport. Është e nevojshme që në kohën më të shkurtër të mundshme të punësohet personeli për punë në sektorin ligjor (4 vetë), Komisionin për Integritet Evropian (2 vetë), Sektori e TI (2 vetë) dhe në sektorin për marrëdhënie me publikun (2 vetë).

Është e nevojshme të ketë transparencë gjatë shpenzimit të këtyre mjeteve. Megjithatë Grupi Parlamentar, dmth shefi i tij vendos mbi mënyrën se si do të shfrytëzohet mbështetja e ekspertit, këto fonde buxhetore ndahen vetëm kur të nënshkruhet kontrata. Kontratat për punësim duhet të nënshkruhen nga Sekretari i Kuvendit i cili duhet të sigurojë që kontratat janë në pajtueshmëri me ligjet e zbatueshme. Të gjitha kontratat që nënshkruhen në këtë mënyrë duhet t'i nënshtrohen auditimit të Auditorit Gjeneral dhe inspektimeve tjera financiare dhe të punës. Kjo garanton që Grupet Parlamentare veprojnë përgjegjshëm me paratë publike. Procedurat e punësimit duhet të ndiqen saktësisht për tu mundësuar kandidatëve më të mirë të përzgjidhen dhe plotësojnë pozitën në gjithë shërbimin civil të Kuvendit.

Për të punësuarit e tanishëm dhe personelin e ardhshëm duhet të organizohen kurset adekuate në lokalet e ndërtesës së Kuvendit dhe mjetet financiare për këtë duhet të sigurohen. “Plani trajnues” ekzistues i përgatitur nga sektori i Personelit duhet të plotësohet për të plotësuar nevojat në rritje. Fondet që tani janë vënë në dispozicion nga donatorët e huaj duhet të shfrytëzohen bazuar në prioritetet e Kuvendit, duke propozuar kurse dhe seminare që respektojnë kushtet dhe nevojat e punës së Kuvendit. Kuvendi nuk duhet të presë që ofertat të vijnë nga jashtë. Përcaktimi i nevojave dhe mënyra si të përmbushen ato duhet të jenë më shumë në duart e Kuvendit e Kosovës.

Në punën e administratës duhet të zhvillohet dhe stimulohet puna ekipore, bashkëpunimi ndërmjet njësive organizative, veçanërisht krijimi i ekipeve që zbatojnë projekte në fusha të caktuara dhe ndërtojnë marrëdhënie të mira kolegjiale. Ambienti i mirë i punës që bazohet në marrëdhëniet e mira dhe gatishmërinë për të ndihmuar një koleg në punë është kusht paraprak për cilësi dhe punë efikase. Qarkullimi i nevojshëm i informatave nga mbledhjet e Sekretarit të Përgjithshëm dhe nga mbledhjet e shërbimeve të sektorëve të ndryshëm duhet të bëhet përmes sistemit elektronik për menaxhim të dokumenteve (DMS) apo Tabelave të Shpalljeve etj.

Rekomandimet:

- Të sigurohet zbatimi i Rregullores mbi Statusin e Shërbimit Civil të Kuvendit të Kosovës, të miratuar nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës;
- Të ofrohet mbështetje adekuate, të pavarur, profesionale, administrative dhe teknike në kohën më të shkurtër të mundshme dhe në harmoni me burimet tuaja, që do të mund të kërkonte ndryshime në aktet që mbulojnë Shërbimet për Grupet Parlamentare;
- Të forcohen sektorët e shërbimeve (ligjor – juridik, hulumtimi dhe dokumentimi me bibliotekën, ndarja e informatave mbi marrëdhëniet publike etj);
- Të definojnë qartë rregullat mbi shpenzimin e përgjegjshëm të mjeteve të dedikuara për Grupet Parlamentare ;

⁷⁵ Përshkrimi i përgjegjësisë të Seksionit për Media dhe Marrëdhënie me Publikun bëhet në “Rregulloren mbi Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Kosovës”, e miratuar nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës më 25 Prill 2007 në Prishtinë, f.9;

- Të punësohet personel i kualifikuar që njih mirë gjuhët e huaja, funksionimin e Bashkimit Evropian dhe ka kualifikime tjera;
- Të sigurohet qarkullim i detyrueshëm dhe i vazhdueshëm të informatave ndërmjet njësive organizative përmes takimeve të rregullta në mënyrë që të mundësohet qasja në informatat e brendshme dhe të jashtme;
- Të zhvillohen më tutje aftësitë profesionale të administratës së parlamentit përmes trajnimeve të rregullta;
- Të planifikohet (duke marrë parasysh shtrëngimet financiare) dhe zbatohet një orar për organizimin e përkrahjes profesionale dhe administrative për Grupet Parlamentare.

6.7. Puna efikase e Kuvendit të Kosovës

Demokracia kërkon që atyre të cilët zgjidhen në mënyrë të lirë duhet dhënë kompetencat të përmbushin me efikasitet përgjegjësitë e tyre kushtetuese. Në të njëjtën kohë, për tu konsideruar demokratike një legjislaturë duhet tu përmbahet standardeve nëpër krejt spektrin e jetës legjislative, në mënyrë të veçantë sa i përket organizimit, procedurave, funksioneve dhe vlerave të legjislaturës siç janë renditur në këtë dokument. Respektimi selektiv apo “vetëm respektimi i standardeve që sjellin dobi” nuk garanton krijimin e një legjislature demokratike, dhe në fakt mund të shërbej si fasadë apo mbulesë për praktika jo-demokratike. Masa e vërtetë e efikasitetit të legjislaturës shikohet nga ajo se sa mirë e bën politikën publike në emër të qytetarëve që përfaqësojnë anëtarët e vet, dhe nga cilësia e mbikëqyrjes së saj ndaj ekzekutivit.⁷⁶ Në mënyrë që të ketë performancë më të mirë gjatë ekzekutimit të kompetencave të veta kushtetuese, Kuvendi duhet së paku të ketë kushte elementare për punën e vet. Disa nga këto kushte janë elaboruar në tekstin e mëposhtëm.

6.7.1 Plani Vjetor i Punës i Kuvendit të Kosovës

Një nga kushtet më të rëndësishme që mundëson transparencë, efikasitet, sasi dhe cilësi të punës është organizimi dhe programimi i punës së Kuvendit. Deputetët duhet ta dijnë kur Kuvendi do të ketë seancë dhe çfarë çështjesh presin të shqyrtohen nga Kuvendi. Kjo nuk është më pak e rëndësishme për publikun i cili duhet të jetë në gjendje të përfshihet me vërejtjet dhe opinionet e veta apo të ndjek procesin dhe diskutimet.

Është e nevojshme që në fund të seancës vjetore të miratohet plani vjetor i punës i Kuvendit të Kosovës për vitin që vjen. Plani përcakton ditët e muajit kur do të mbahen seancat plenare, takimet e komisioneve parlamentare, puna e deputetëve në Grupet Parlamentare dhe puna e deputetëve me votues. Gjithashtu është e rëndësishme të bëhet një plan i detajuar së paku dy muaj më herët që do të bënte të njohur se cili draft-ligj diskutohet dhe cili komision parlamentar është i përfshirë. Draft-planet duhet të përgatiten nga administrata (Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me departamentin për shërbime për deputetët) dhe atëherë të miratohen nga Kolegjiumi i Kryetarit apo në formën e tanishme të Kryesisë së Kuvendit në bashkëpunim me liderët e grupeve parlamentare. Draft-ligjet duhet të përgatiten dhe dorëzohen me kohë në mënyrë që deputetët të mund të paraqesin si duhet vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Rishikimi i planeve të punës mund të bëhet në rrethana të caktuara dhe kjo mund të bëhet përmes procedurës së njëjtë siç janë miratuar. Është e rëndësishme të theksohet që të dy planet duhet të jenë në dispozicion të deputetëve, Administratës së Kuvendit, Qeverisë, medimeve dhe publikut të gjerë.

Rekomandime:

- Të përgatitet kalendari vjetor i punës së Kuvendit të Kosovës;
- Të përgatiten plane të detajuara dy-mujore të punës;

⁷⁶ Instituti Kombëtar Demokratik për Çështje Ndërkombëtare (2006) “Drejt Zhvillimit të Standardeve Ndërkombëtare për Legjislaturat Demokratike”, Uashington;

- Planet vjetore dhe ato dy-mujore të vihen në dispozicion të deputetëve, administratës dhe publikut të gjerë.

6.7.2 Hapësira e punës dhe kushtet tjera për punë

Në mënyrë që të jetë në gjendje të zbatojë kompetencat e veta, Kuvendi duhet të ketë hapësirë pune për deputetë, Grupet Parlamentare, komisionet parlamentare, seancat plenare, administratë dhe për punën e deputetëve me qytetarë jashtë Kuvendit. Aktualisht, Kuvendi nuk ka kushte të përshtatshme pune meqë i mungon hapësira e nevojshme dhe kushtet tjera materiale për punë.

Në objektin e Kuvendit dhe ndërtesat në afërsi të saj është e nevojshme të ketë:

- Hapësira pune për çdo deputetë;
- Hapësira pune për Grupe Parlamentare bazuar në numrin e deputetëve;
- Hapësira pune për kryetarë të komisioneve parlamentare
- Hapësira pune për takime të komisioneve parlamentare
- Hapësira pune për Administratën e Kuvendit.

Administrata e Kuvendit duhet të përgatis një raport të nevojave që paraqiten dhe të planifikojë si ti plotësojë ato nevoja. Mjetet e nevojshme financiare duhet të vlerësohen në bazë të një analizë të plotë të Kuvendit. Një vlerësim bazik është paraqitur në kapitullin mbi burimet financiare.

Profesionalizimi i deputetëve (deputetët që janë të angazhuar çdo ditë në seancat plenare apo komisionet parlamentare me aktivitetet e veta). Kjo kërkon nga disa deputetë të udhëtojnë çdo ditë nga vendet e tyre ku jetojnë dhe disa nga këto vendbanime janë më shumë se 50 km larg kryeqytetit.

- **Automjetet zyrtare** duhet të përdoren për punë zyrtare. Rregulloret duhet të përcaktojnë llojin e automjetit, mënyrën e përdorimit (me apo pa shofer). Të dhënat e udhëtimeve dhe destinacioni i tyre duhet të jenë publike.

- **Telefonat tokësor dhe telefonat mobil zyrtar**, duhet dhënë bazuar në kritere dhe standarde të caktuara dhe të shfrytëzohen deri në shkallë të caktuar që paguhet nga buxheti.

- **Kompjuterët zyrtar**, jepen sipas kritereve dhe standardeve të caktuara.

Rekomandime:

- Prioritet duhet dhënë përpilimit të një plani për të zgjidhur mungesën e hapësirës për punë (më shumë detaje në kapitullin mbi burimet financiare);
- Të aprovohen norma dhe standarde të përshtatshme përmes të cilave mund të caktohet lloji dhe përmasa e kushteve materiale.

6.7.3 Sistemi Informativ

Shkëmbimi i informatave në Kuvendin e Kosovës nuk është duke u bërë në një mënyrë të kënaqshme dhe të organizuar. Nuk është e mjaftueshme të mbahet faqja e internetit e Kuvendit. Kuvendit i nevojitet gjithashtu një bazë e brendshme e të dhënave ku mund të ketë lehtësisht qasje në dokumentet që kanë të bëjnë me aktivitetet parlamentare.

Zyra për propozime dhe parashtesa tanimë ka qasje në Sistemin Elektronik për Menaxhim të Dokumenteve (DMS) dhe duhet të jetë përgjegjëse për futjen e informatave në sistem. Falë përkrahjes nga organizatat ndërkombëtare (sikur UNDP) është investuar shumë në Sistemin Elektronik për Menaxhim të Dokumenteve por sistemi as tani nuk është funksional.

Puna efektive kërkon sistem efektiv informativ që është i pavarur nga ndikimi dhe kontrolli i jashtëm. Politikat që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e sistemit duhet të krijohen nga udhëheqja e Kuvendit.

Dokumentet që i dërgohen Kuvendit apo krijohen në Kuvend duhet të arkivohen në një bazë të të dhënave të strukturuar e cila do të ishte në dispozicion të të gjithë deputetëve dhe Administratës së Kuvendit përmes rrjetit të kompjuterëve në Kuvend (Intranet). Vendosija e informatave në bazën e të dhënave duhet të bëhet në bazë të principit të decentralizimit, ku personi që pranon dokument (Kabineti i Kryetarit të Kuvendit, personeli) apo personi që krijon dokument (deputetët, personeli, komisioni parlamentar) i cili duhet të jetë përgjegjës për futjen e dokumenteve në bazën përkatëse të të dhënave. Një sistem i tillë mundëson që çdo deputet dhe personeli të kenë qasje nga kompjuteri i tyre në të gjitha dokumentet në mënyrë të shpejt, thjeshtë dhe të lirë.

Gjatë zhvillimit të mëtejshëm të sistemit informativ në Kuvend është e nevojshme të sigurohet që dokumentet relevante të jenë në dispozicion të publikut përmes internetit. Një listë e pjesërishme e asaj çfarë duhet të jetë në dispozicion është dhënë më poshtë.

- Kalendar i vjetor dhe plani i detajuar i punës;
- Mbledhjet e Kuvendit: ftesa për mbledhje, ndryshimet në rend të ditës, njoftimi mbi zgjatjen e mbledhjes, transkriptet nga mbledhjet;
- Mbledhjet e komisioneve parlamentare: ftesa për mbledhje, ndryshimet në rend të ditës, njoftimi mbi zgjatjen e mbledhjes, transkriptet nga mbledhjet;
- Draft-ligjet: teksti i draft-ligjit në të gjitha fazat e procesit legjislativ, amendamentet e propozuara, raportet e komisioneve parlamentare dhe tekstet tjera të lidhura me draft-ligjet, rezultatet e votimit;
- Propozimet e akteve tjera: teksti i aktit të propozuar në të gjitha fazat e procesit legjislativ, amendamentet e propozuara, raportet e komisioneve parlamentare dhe tekstet tjera të lidhura me draft-ligjet, rezultatet votuese;
- Ligjet e miratuara që janë dërguar për tu shpallur zyrtarisht, teksti i ligjeve të miratuara
- Aktet e miratuara: teksti i akteve të miratuara
- Pyetjet parlamentare: teksti i pyetjeve dhe përgjigjeve
- Raportet: teksti i raporteve nga institucionet të cilat janë të obliguara ti raportojnë Kuvendit, raportet e komisioneve parlamentare dhe vendimet e marra.
- Duhet të ketë lehtësisht qasje në të dhënat e votimit të çdo deputeti

Rekomandime:

- Të krijohet një rrjet i brendshëm kompjuterik dhe të azhurnohet rregullisht me materiale dhe dokumente që pranon Kuvendi apo krijohen brenda Kuvendit dhe lejoni qasje publike vetëm për sferën publike;
- Të funksionalizohet dhe shfrytëzohet Sistemi i Tanishëm Elektronik për Menaxhimin e Dokumenteve;
- Të sigurohet azhurimi i faqes së internetit të Kuvendit në bazë të rregullt dhe përcaktoni zinxhirin e duhur komandues për freskimin e saj.

6.7.4 Burimet Financiare

Nuk ka dyshim që Kuvendi i Kosovës ka nevojë për më shumë mjete se sa ato që i janë ndarë për të përmbushur rolin e vet të ri kushtetues. Është e nevojshme që duke filluar nga viti 2009 të ngritet gradualisht shuma e mjeteve duke u bazuar në një plan zhvillimor të përgatitur me kujdes. Pas miratimit të planit dhe aktiviteteve të veta, Kuvendi duhet ti paraqesë atë Qeverisë dhe veçanërisht Ministrit të Ekonomisë dhe Financave dhe Zëvendës Kryeministrit përgjegjës për integritet në Bashkimin Evropian. Nevojat e reja janë të lidhura me forcimin e rolit të demokracisë parlamentare, i cili do të jetë një nga kushtet më të rëndësishme për të dëshmuar

përbushjen e kritereve të Kopenhagës. Kuvendi duhet të marrë masa ligjore dhe të brendshme për të siguruar një mënyrë transparente dhe të përgjegjshme të shpenzimit të mjeteve buxhetore.

6.7.5. Analiza e buxhetit të Kuvendit për vitin 2008

Në buxhetin e vitit 2008 nuk ka mjetet materiale të mjaftueshme për një funksionim normal të Kuvendit të Kosovës. Kjo mund të konfirmohet nga shumë tregues - duke filluar me numrin e të punësuarve deri te mjetet për krijimin e kushteve materiale dhe teknike për punë të Kuvendit. Pagat e deputetëve dhe personelit të Kuvendit tregojnë një diferencë të madhe në lartësinë e pagave të tyre dhe kjo mund të shpie tek përkrahja jocilësore për punën e deputetëve dhe grupet parlamentare. Një krahasim për shumën e ndarë për të punësuarit (shih Tabelën 1) në Parlamentin e Republikës së Sllovenisë (17,2 mil. Euro) dhe Kosovës (3, 9 mil. Euro) tregon diferencën e madhe në numër të personelit – në Slloveni rreth 350 dhe në Kosovë 157 dhe madje një diferencë edhe më të madhe në të ardhurat. Mjetet e ndara për pagat e personelit në Kosovë janë mesatarisht 6 herë më të vogla se sa në Slloveni.

Tabela 1. vërteton që buxheti për shpenzimet materiale dhe mirëmbajtje nga Buxheti i Kosovës (1,2 mil. Euro) është mesatarisht 5 herë më i vogël se sa buxheti për qëllime të njëjta i Republikës së Sllovenisë (6.4 mil. Euro). Kjo diferencë është e dukshme por ende është më e vogël se sa diferenca në nivelin e pagave. Buxheti i Kosovës siguron mjete të limituara për shpenzime kapitale (1,5 mil Euro), krahasuar me Slloveninë vetëm 2 herë më pak, megjithëse Kuvendi nuk ka hapësirë për deputetët, Grupet Parlamentare dhe personelin. Disa Grupe Parlamentare kanë hapësirë vetëm për takimet e tyre të përbashkëta dhe jo për takimet individuale të deputetëve. Deputetët që janë shefa të grupeve parlamentare janë në pozitë më të mirë por këto hapësira nuk kanë në afërsi vende për asistentët e tyre dhe stafin tjetër të komisioneve parlamentare. Në të njëjtën kohë, disa pjesë të godinës së Kuvendit të Kosovës shfrytëzohen nga Kryetari i Kosovës dhe një Ministri e Qeverisë.

Ekziston një diferencë në financimin e partive politike ndërmjet Sllovenisë (2.8 mil. Euro) dhe Kosovës (1.9 mil. Euro). Megjithatë, duhet pasur parasysh se të dy sistemet nuk financojnë gjërat e njëjta. Në Slloveni, financimi i partive politike nuk lejon që paratë të shfrytëzohen për të financuar harxhimet e bëra në fushata elektorale.

Duke krahasuar vërehet që dallimet mund të rezultojnë me funksionim joadekuat dhe joefikas të Kuvendit apo me një nevojë për të tejshpenzuar mjetet në një vit buxhetor. Një shembull është blerja e kompjuterëve (laptop-ëve) pa blerjen e pajisjes Wi-Fi dhe mosfunksionimi i mirëmbajtjes së TI. Ka pasur gjithashtu investime në Sistemin Elektronik për Menaxhim të Dokumenteve i cili ende nuk është operacional. Gjithashtu, Kuvendi nuk ka Ekipa adekuate të TI-e që do të thotë jo mjaft autonomi të Kuvendit. Krejt kjo është e rëndësishme për një punë cilësore të deputetëve dhe për informim cilësor të publikut rreth punës së parlamentit. Së fundmi, në buxhet nuk ka linjë buxhetore për trajnime profesionale për deputetët dhe personelin dhe për blerjen e literaturës për Kuvend.

Buxheti i Kuvendit të Kosovës për vitin 2008 prej rreth 8.7 milionë Eurosh nuk mundëson kushte për mbikëqyrje efikase legjislative dhe punë përfaqësuese të parlamentit. Nëse heqim shumën e caktuar për paga të deputetëve dhe Partitë Parlamentare, rreth 5.8 milionë Euro, Kuvendit i mbetet një shifër prej më pak se 3 milionë për pagat e personelit, shpenzimet operationale, dhe investimet kapitale. Kjo shumë nuk mundëson kryerjen e të gjitha investimeve të nevojshme, as mbështetje ekspertësh për punën e Kuvendit dhe për komisionet parlamentare, deputetët dhe Grupet Parlamentare. Përkrahja që jepet nga organizatat ndërkombëtare mbulon zbrazëtitë deri në një shkallë por duhet pasur parasysh se kjo nuk është një zgjidhje e afatgjatë.

Vlerësohet që shuma për punë normale të Kuvendit duhet të ngritet për përafërsisht 13 milionë Euro në vit, varësisht nga numri i personelit, niveli i pagave të deputetëve dhe personelit dhe shuma për mbështetje me ekspertë për grupet parlamentare. Kjo shumë nuk përfshin investimet kapitale, si adaptimi i hapësirave të punës së Kuvendit që janë të nevojshme për punë efikase. Kjo është e vështirë të vlerësohet pa vizion më të qartë se ku të vendosen institucionet tjera të Kosovës. Nëse do të kishte hapësira të punës në dispozicion për Kryetarin e Kosovës dhe për

Ministritë atëherë gjetja e zgjidhjes për hapësirë pune për Kuvendin do të ishte më e lehtë. Ka nevojë të hartohet një strategji e përgjithshme se ku do të vendosen të gjitha këto institucione.

Buxheti i tanishëm: Analizat e buxhetit të tanishëm të Kuvendit të Kosovës në krahasim me buxhetin parlamentar të një nga vendet e reja të Bashkimit Evropian, Republikës së Sllovenisë tregojnë dallime të mëdha. Buxheti i Kuvendit të Kosovës është pothuaj 4 herë më i vogël se sa buxheti i Parlamentit të Republikës së Sllovenisë, ndërsa diferenca absolute është 22 milionë Euro.

Tabela 1. Krahasim i buxhetit të Parlamentit të Sllovenisë dhe Kosovës për vitin 2008

	Parlamenti i Sllovenisë	Kuvendi i Kosovës	Diferenca
BUXHETI PËR VITIN 2008.	30.411.179	8.719.962	- 21.691.217
A. Pagat dhe kompensimet tjera materiale për deputetë dhe personelin e Kuvendit	15.221.966	3.902.486	- 11.319.480
B. Shpenzimet materiale dhe mirëmbajtja	6.424.114	1.231.000	- 5.193.114
C. Investimet dhe mirëmbajtja e investimeve.	3.484.292	1.524.550	- 1.959.742
D. Përkrahja me Ekspertë për deputetë dhe Grupet Parlamentare	2.070.315	0	- 2.070.315
E. Financimi i partive politike	2.825.504	1.901.783	- 923.721

Arsyet kryesore për diferencat ekzistuese mund të kuptohen në vijim:

- Parlamenti Slloven harxhon 5 herë më shumë për paga dhe kompensime materiale për deputetë dhe personel. Numri i personelit në Kosovë është më i vogël dhe të ardhurat janë më të ulta. Diferenca është veçanërisht e madh me pagat e personelit - mesatarisht pagat në Kosovë janë 6 herë më të vogla se në Slloveni ndërsa diferenca në paga dhe kompensime materiale për deputetë në mes Sllovenisë dhe Kosovës është mesatarisht 2 me 1;
- Parlamenti Slloven shpenzon 5 herë më shumë në material dhe mirëmbajtje. Kuvendi i Kosovës ka shpenzime më të ulta materiale për shkak të përkrahjes së kufizuar për deputetë sa i përket stafit dhe mbështetjes materiale;
- Parlamenti Slloven shpenzon rreth 2 herë më shumë në investime dhe mbajtje të investimeve por, ne duhet ta kuptojmë që shumica e investimeve në Slloveni janë përfunduar para një kohe të gjatë ndërsa në Kosovë akoma duhet pritur të bëhen;
- Në Parlamentin Slloven ka një linjë buxhetore prej 2 milionë Eurosh për të mbuluar shpenzimet e mbështetjes për deputetë dhe Grupet Parlamentare ndërsa në buxhetin e Kuvendit të Kosovës nuk ekziston një linjë e tillë. Një pjesë shumë e vogël është në linjën buxhetore që ka të bëjë me shpenzimet materiale dhe financimin e partive politike;
- Dhe përfundimisht, Parlamenti Slloven shpenzon më shumë përafërsisht 1/3 e mjeteve për financimin e partive politike. Duke pasur parasysh dallimin në dedikimin e mjeteve nga linja buxhetore për partitë politike, shuma për financimin e partive politike në Kosovë është e mjaftueshme.

Edhe pse Kosova sipas numrit të popullatës është e ngjashme me Slloveninë, GDP-ja e saj është 5 herë më e ultë por kjo nuk do të thotë që buxheti i Kuvendit të Kosovës duhet të jetë 5 herë më i ultë.

Caktimi i buxhetit ideal varet nga detyrat e parlamentit dhe në lidhje me këtë duhet thënë se Kuvendi i Kosovës kryen funksionet e njëjta si Parlamenti i Luksemburgut, Bundestagu Gjerman apo Parlamenti Slloven. Kjo kërkon minimumin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore. Tabela 2 bën krahasimin e të dhënave nga parlamentet e ndryshme. Shohim që Kuvendi i Kosovës ka nivelin më të ulët buxhetor dhe numrin më të vogël të personelit për deputetë nga të gjitha parlamentet e Evropës që janë pasqyruar.

Tabela 2: Deputetët, personeli dhe buxheti i parlamentit⁷⁷ në miliona Euro në disa vende.

Shteti	Numri i deputetëve	Numri i Personelit	Buxheti Gjithsej	Eurot për deputetë	Personeli për deputetë
Austria⁷⁸	183	385 (+ 200)	115 mil.	628 000	2.1 (3.19)
Belgjika	150	519	86.5 mil.	576 000	3.46
Danimarka	179	363	60.3 mil.	337 000	2
Finlanda⁷⁹	200	411 (+ 200)	59.7 mil.	298 000	2.05 (3.05)
Franca⁸⁰	577	1279 (+2130)	440 mil.	762 000	2.2 (5.9)
Gjermania	669	2354	560 mil.	837 000	3.5
Greqia⁸¹	300	598 (+900)	98.3 mil.	327 000	1.9 (4.9)
Irlanda	166	168	53.7 mil.	323 000	1.01
Italia	630	1900	730 mil.	1 159 000	3
Luksemburgu⁸²	60	44 (+60)	17.3 mil. ⁸³	288 000	0.73 (1.73)
Holanda	150	564	71.8 mil.	479 000	3.76
Portugalia	230	387	85.2 mil.	370 000	1.68
Spanja	348	326	94 mil.	270 000	0.93
Suedia⁸⁴	349	600 (+170)	135 mil.	387 000	1.71 (2.2)

⁷⁷ Këto të dhëna për buxhetin jepen në mesatare (varësisht nga viti dhe tregu qarkullues që është përdorur); Informatat mbi numrin e personelit në parlamente nganjëherë nuk përfshijn personelin e Grupeve Parlamentare dhe Asistentëve të deputetëve (varësisht nga sistemi i brendshëm i organizimit të parlamentit të caktuar). Burimi: Hulumtimi i Qendrës Evropiane për Hulumtim Parlamentar dhe Dokumentim (ECPRD) dhe hulumtimi i NDI-it më 2004;

⁷⁸ Personeli në parlament plus 200 asistentë të deputetëve;

⁷⁹ Deputeti ka të drejtë të punësojë një asistent (kontratë afatshkurtër) dhe ai/ajo do të jenë në regjistrin e pagave të parlamentit;

⁸⁰ Personeli parlament dhe 2.130 asistentë të deputetëve;

⁸¹ 1.200 vota punojnë si asistentë të deputetëve (4 për secilin deputet), prej të cilëve 300 paguhen në mënyrë të tërthortë kurse 900 paguhen drejtpërdrejt nga parlamenti;

⁸² Deputetët marrin kompenzim mujor për asistentë hulumtues;

⁸³ Harxhimet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e ndërtesës së parlamentit dhe Grupe Parlamentare paguhen nga shteti;

Mbretëria e Bashkuar⁸⁵	659	1421 (+1812)	445 mil.	675 000	2.15 (4.9)
Slovakia	150	491	24.1 mil.	161 000	3.27
Republika Çeke	200	Rreth 700	28.5 mil.	142 000	3.5
Kroacia	152	333	31.6 mil.	207 000	2.19
Slovenia	80	165	30 mil.	375 000	2.06
Serbia	250	300	26 mil.	104 000	1.20
Mali i Zi	75	55	2.9 mil.	38 000	0.73
Kosova	120	157	8.7 mil.	72 500	1.3

6.7.6. Propozimi i buxhetit të ri

Në mënyrë që Kuvendi të mund të funksionojë normalisht është e nevojshme të ngritet gradualisht buxheti i Kuvendit të ri për 13 mil. Euro. Siç është thënë më herët, dinamika e alokimit të kësaj shume varet drejtpërdrejtë nga përmbushja e planeve sa i përket numrit të personelit, vendimit mbi ngritjen e pagave dhe shumën për përkrahje ekspertësh për Grupet Parlamentare. E njëjta gjë vlen edhe për shpenzimet materiale. Një nga çështjet kryesore është zhvendosja e Zyrës së Kryetarit të Kosovës dhe njëres nga Ministritë e Qeverisë nga ndërtesa e Kuvendit. Duhet mundësuar renovim gradual të tërë ndërtesës së Kuvendit. Për të arritur tek buxheti i llogaritur janë marrë parasysht supozimet në vijim:

1. Pagat dhe kompensimet materiale për deputetët dhe personelin

Një problem i rëndësishëm i administratës publike në çdo vend është caktimi i pagave të personelit të Kuvendit. Në Kosovë është e rëndësishme të vërehet se ka diferencë të madhe në nivelin e pagave ndërmjet deputetëve dhe personelit. Niveli i pagave dhe shpenzimet tjera të punës për deputetë tani kapin shumën prej 2.171 Euro dhe vetëm 375 Euro për pjesëtar të personelit që do të thotë 5 herë më pak. Prandaj, sugjerimi i parë do të ishte që buxheti i ri duhet të përfshijë ngritje në faza deri te një mesatare neto e pagës për anëtarët e personelit prej 375 Eurosh⁸⁶ në 675 Euro ndërsa pagat bruto do të ishin nga 400 deri në 1000 Euro për pjesëtarët më të mirë të personelit.

Gjithashtu supozohet se do të ketë rreth 50 anëtarë të personelit të punësuar në Administratën e Kuvendit të Kosovës dhe rrjedhimisht (njëkohësisht do të ketë 50 persona më shumë për përkrahje të punës së Grupeve Parlamentare, varësisht nga madhësia dhe numri i Grupeve Parlamentare, shih Pikën 4).

⁸⁴ Në përjashtim të 600 pjesëtarëve të personelit, Grupet Parlamentare punësojnë edhe 170 asistentë politik;

⁸⁵ Personeli i parlamentit plus 1.812 asistentë të deputetëve;

⁸⁶ Vlerësohet se paga mesatare mujore për anëtar të personelit është 375 Euro bazuar në të dhënat se nga buxheti parlamentar paguhën 157 anëtarë të personelit që paraqet numrin e të punësuarve të planifikuar në buxhet;

Tabela 3: Propozimi i buxhetit të ri të synuar të Kuvendit të Kosovës në Euro.

	Buxheti i Tanishëm i Kuvendit	Propozimi për Buxhetin e ri të Synuar
	8.719.962	12.500.000
1. Pagat dhe kompensimet materiale për deputetët dhe personelin e Kuvendit	3.902.486	5.000.000
2. Shpenzimet materiale dhe mirëmbajtja	1.231.000	2.000.000
3. Investimet dhe Mbajtja e Investimeve.	1.524.550	2.500.000
4. Përkrahja me Ekspertë për deputetët dhe Grupet Parlamentare	0	1.000.000
5. Financimi i partive politike	1.901.783	2.000.000

Megjithëse në shikim të parë ky propozim mund të duket si ngritje e rëndësishme e menjëhershme e pagave për personelin, duhet pasur parasysh faktin që nuk ka shpenzim më të madh se sa ai që bëhet si rezultat i punës së keqe në parlament dhe si pasojë e ligjeve të këqija. Në mënyrë që Kuvendi të përmbush rolin e vet kushtetues në mënyrën më të mirë, ai duhet të tërheq vëmendjen e individëve më të aftë dhe shumicës së personave të rinj nga universitetet. Për të arritur këtë, është e nevojshme të bëhen oferta stimuluese përmes pagave më të mira dhe mundësive të trajnohen në vend dhe jashtë vendit. Në këtë kontekst, linja buxhetore për pagat e personelit duhet të ngritet. Sa i përket pagave të deputetëve, supozohet se ato janë në një nivel të kënaqshëm për momentin andaj ajo pjesë e buxhetit mbetet e njëjtë.

Rekomandime:

- Pagat e personelit të Kuvendit duhet të ngriten me qëllim që të punësohet, mbahet dhe stimulohet personeli cilësor.
- Pagat e deputetëve duhet të mbesin në nivele të njëjta; masa të përshtatshme duhet të merren me qëllim që të parandalohet konflikti i interesit dhe të vendosen dënime për mungesa të paarsyeshme të deputetëve nga puna në Kuvend.
- Kuvendi duhet të rrisë numrin e personelit për rreth 50 veta.

2. Shpenzimet materiale dhe mirëmbajtja

Është e qartë që shuma e tanishme prej rreth 1.2 mil. eurosh nuk mjafton për të mbuluar shpenzimet materiale dhe për mirëmbajtje në një parlament aktiv me një numër më të madh të personelit. Buxheti i Parlamentit Slloven në këtë sektor është pesë herë më i lartë (pa përfshirë grupet parlamentare) dhe është rreth 6 mil. euro. Një parlament aktiv ka nevojë për më shumë kompjuterë, printerë, pajisje zyre, më shumë mjete për udhëtime zyrtare, për pranimin e delegacioneve të huaja dhe gjithashtu për shërbimet e lidhura me personel veçanërisht për përkthyesit. Kjo do të bëhet e rëndësishme sapo ta zvogëlojnë përkrahjen e tyre organizatat ndërkombëtare që mbështesin punën e Kuvendit⁸⁷.

Rekomandime:

- Mjetet që do të shfrytëzohen për shpenzime materiale dhe të mirëmbajtjes duhet të ngriten së paku deri në nivelin prej 2 mil. eurosh.

3. Investimet dhe Mbajtja e Investimeve

⁸⁷ Disa organizata të huaja donatore mbulojnë një pjesë të këtyre shpenzimeve. Donacionet e tilla duhet të përfshihen në buxhet të Kuvendit (dhe në të gjithë shfrytëzuesit tjerë të buxhetit). Kjo do të thotë që, duhet të ketë mirëmbajtje dmth duhet edhe të jepet dëshmi për kompjuterin që Kuvendi e ka marrë si donacion dhe ato duhet të përfshihen në buxhet si mjete që do të mbulonin shpenzimet;

Shuma e tanishme vjetore prej 1, 5 mil. Eurosh në Kosovë krahasuar me 3,5 mil. euro në Slloveni nuk është një shumë e vogël. Është e rëndësishme të vazhdohet me kompjuterizimin e Parlamentit dhe renovimin e hapësirave të punës. Është vështirë të llogaritet çmimi për këto propozime por supozohet që rreth 2,5 mil. euro duhet siguruar për fillimin e këtij investimi të rëndësishëm.

Ripërtëritja e sistemit informativ: Një nga prioritetet e tanishme duket të jetë krijimi i një sistemi të qëndrueshëm informativ, i cili do të shërbente si përkrahje sistemit legjislativ, punës së deputetëve dhe Grupeve Parlamentare. Një projekt i tillë afatgjatë kompleks i ndërtimit të sistemit informativ do të kërkonte shumë të madhe, së paku disa miliona Euro. Në Slloveni, gjatë pesë viteve të ardhshme do të shpenzohen rreth 6 mil. Euro në ripërtëritjen e sistemit informativ.

Sektori i Kuvendit përgjegjës për teknologji informative duhet të bëjë një regjistër të sistemit ekzistues të teknologjisë informative dhe të hartojë një plan për ripërtëritjen e saj dhe zgjerimin për pesë vitet e ardhshme. Planet me shkrim duhet të përmbajnë vlerësime për shpenzimet për çdo vit. Është e mundshme që shpenzimet e një plani të hartuar mirë të mbulojnë nga programet financuese për Kuvend përkatësisht një projekt i BE-ë i propozuar për implementim.

Në kuadër të ripërtëritjes së sistemit informativ nuk duhet harruar librat, shtypin ditor dhe periodik dhe literaturën tjetër. Kuvendi tanimë ka investuar mjete materiale në renovimin e bibliotekës. Është e nevojshme të mendohet për blerjen e librave, publikimeve, revistave, kompjuterëve, instalimit të qasjes online në rrjetet kompjuterike, trajnimin e personelit në këto fusha dhe për të planifikuar kujdesshëm dhe me kohë investime të tilla.

Zgjidha e çështjes së mungesës së hapësirës së punës: Pjesa e dytë më e rëndësishme e investimeve ka të bëjë me sigurimin e hapësirës adekuate për punë të komisioneve parlamentare, grupeve parlamentare, deputetëve dhe personelit në ndërtesën e Kuvendit. Nuk është llogaritur kostoja e këtyre shpenzimeve. Administrata e Kuvendit duhet të përgatis një dokument që do të përcaktoj nevojat e saj dhe një plan zhvillimor që synon sigurimin e hapësirës së nevojshme të punës. Një opsion për tu marrë parasysh është zhvendosja e Zyrës së Kryetarit të Kosovës dhe Ministrisë së Transportit nga ndërtesa e Kuvendit. Pas kësaj, një organ i emëruar i Kuvendit duhet të shqyrtojë opsionet dhe të vendos brenda kohës më të shkurtër të mundshme mbi zgjidhjen më të mirë për këtë çështje. Ky dokument duhet të shfrytëzohet më vonë si bazë për një tender publik për një projekt të rindërtimit të ndërtesës ekzistuese.

Kërkesa për ngritjen e shumës totale të buxhetit për vitin 2009 (që duhet të miratohet deri në fund të vitit 2008) duhet të potencojë urgjencën e këtij projekti. Ata të cilët marrin vendim për këtë çështje duhet të zgjedhin opsionin që do ta zgjidh këtë çështje për një periudhë më të gjatë. Në ndërkohë, pjesa tjetër e investimeve duhet drejtuar në zgjidhjet brenda ndërtesës ekzistuese apo marrjes me qira të hapësirave të punës në afërsi të ndërtesës së parlamentit (kjo do të rrisë shpenzimet).

Plani afatgjatë për zhvillimin e projekteve: Në fund, do të ishte mirë nëse buxheti i Kosovës përmban planin afatgjatë përkatësisht projektet zhvillimore për Kuvendin. Kjo do të nënkuptonte që me pjesën e përgjithshme të buxhetit (klasifikimi i ekonomisë) dhe pjesën e veçantë të buxhetit (i ndarë nga institucionet dhe programet) do të ekzistonte një pjesë e tretë për planifikim të linjave afatgjata të buxhetit.

Si shembull, në Slloveni, kjo pjesë përfshin planin financiar për katër vjet për projektet e ardhshme: investimin në sistemin informativ, në pajisje audio dhe video, adaptimin e kateve të caktuara të ndërtesës së Kuvendit, blerjen e licencave, blerjen e veturave, adaptimin e pajisjes së sigurisë dhe në fund punët më të mëdha në mbajtje të investimeve. Investimet në programet zhvillimore për katër vjet në Slloveni kapin shumën prej 14 mil. Eurosh.

Rekomandime:

- Buxheti në pjesën e investimeve duhet të ngritet gjatë vitit të ardhshëm për rreth një milion Euro, dmth.: nga 1.5 mil. Euro në 2.5 mil. Euro derisa investimet kryesore kapitale të përfundohen.

- Kërkesa për ngritjen e buxhetit duhet të racionalizohet mirë me planet afatgjata të hartuara kujdesshëm për ripërtëritjen e sistemit informativ, zgjerimin e hapësirës së punës për komisionet parlamentare dhe grupet parlamentare, sigurimin e apartamenteve apo pagimin ku është e nevojshme dhe investimet tjera

4. Përkrahja me ekspertë për deputetë dhe Grupet Parlamentare

Edhe pse përkrahja me ekspertë për deputetë dhe Grupet Parlamentare është një nga pikat më të rëndësishme dhe në Slloveni merr 8% të buxhetit parlamentar, në buxhetin e Kosovës nuk ekziston. Këto buxhete janë veçanërisht të rëndësishme për punën e grupeve parlamentare opozitare, meqë grupet parlamentare dhe anëtarët e tyre që nuk janë pjesë e koalicionit qeverisës, në thelb, të vetmen përkrahje me ekspertë që marrin është nga struktura partiake apo shërbimet profesionale të grupeve parlamentare. Në Slloveni përkrahja me ekspertë për grupet parlamentare mesatarisht kap shumën prej 22 000 Eurosh për deputetë. Duhet marrë parasysh përfshirja graduale e këtij sistemi në Kuvendin e Kosovës, propozimi ynë është që të themelohen shërbime të tilla me 50% të buxhetit që tani jepet nga Parlamenti Slloven për deputetë.

Një propozim i tillë nënkupton sigurimin e 1 mil. Eurove nga të cilat 400.000 Euro për rreth 50 pjesëtar të personelit të punësuar në Grupet Parlamentare të lidhura me mandatin e deputetëve, dhe rreth 600.000 Euro për hartimin e studimeve, analizave, opinioneve, draft-ligjeve, amendamenteve për punën e Grupeve Parlamentare. Në këtë kornizë nuk janë përfshirë shpenzimet e drejtpërdrejta materiale, për funksionimin e Grupeve Parlamentare si shpenzimet e mirëmbajtjes dhe hapësirës së punës që janë pjesë e shpenzimeve materiale të Kuvendit.

Në shumicën e Parlamenteve të zhvilluara biblioteka është një nga institucionet më të rëndësishme. Ajo siguron qasje në hulumtimin e nevojshëm, ofron dokumentet e kërkuara për hulumtim dhe është depo e periodikëve relevant nacional dhe ndërkombëtar. Kapaciteti hulumtues i bibliotekës së Kuvendit të Kosovës është tani i varfër. Shumë anëtarë nuk janë në dijeni për ekzistencën e saj.

Rekomandim:

- Kuvendi duhet të sigurojë një buxhet për të garantuar përkrahje me ekspertë për deputetë, dhe Grupet Parlamentare që kap shumën prej 1 mil. Eurosh;
- Kuvendi duhet të rrisë numrin e personelit me kontratë afatshkurtër që do të lidhej me mandatin e Grupeve Parlamentare me ç'rast do të punësohej personel i ri prej 50 vetash.
- Në kompleksin fizik të bibliotekës nevojitet instalimi i një sistemi adekuat të ngrohjes/freskimit. Biblioteka kërkon kompjuterë që e kanë të instaluar rrjetin e internetit aty ku ndodhen. Librarisë duhet ndarë fondet adekuate për të paguar abonimet për gazeta ditore dhe një buxhet i vogël për të siguruar librat dhe periodikët e nevojshëm. Një lidhje elektronike me bibliotekën kombëtare duhet të vendoset. Brenda bibliotekës duhet krijuar një kapacitet i dedikuar dhe i paanshëm hulumtimi që do të hulumtonte në bazë të vazhdueshme për anëtarët individual të Kuvendit dhe komisionet.

7. PËRFUNDIM

Ky raport është përgatitur për të siguruar një pasqyrë të situatës së tanishme dhe një zgjidhje për të ardhmen për Kuvendin e Kosovës. Ekzistojnë një numër fushash që janë trajtuar në këtë Raport, por nuk është bërë analizë apo propozuar rekomandime përmbajtjesore. Një shembull në lidhje me këtë është administrata e Kuvendit. Kuvendi megjithatë ka një raport gjithëpërfshirës në këtë temë që i është dorëzuar nga AER-i, i financuar nga Konzorciumi i katër Parlamenteve Evropiane.

Sa i përket rekomandimeve që bartin implikime të mëdha financiare, si renovimi i ndërtesës së Kuvendit apo sigurimi i hapësirave për zyra të deputetëve rekomandohet që të angazhohet një kontraktor kompetent i cili do të zhvillonte një vlerësim të kostos dhe afateve të nevojshme kohore për zbatim të një projekti të tillë. Ky Raport përmban një numër të madh të rekomandimeve që mund të zbatohen me pak apo kurrfarë ndikimi në buxhet si: krijimi i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe Komisioni mbi Mbikëqyrjen e Agjencisë për Inteligjencë dhe Siguri, por fushat tjera do të kërkojnë derdhje substanciale fondesh. Iniciuesit e këtij vlerësimi shpresojnë që Kryesia e Kuvendit të Kosovës do të bëjë një shqyrtim të detajuar të këtij Raporti dhe do të zbatojë sa më shumë rekomandime me burimet financiare në dispozicion.

Në mënyrë që të zbatohen ndryshimet e rekomanduara në këtë raport, Kryesia nën udhëheqjen e Kryetarit ftohet të formoj një grup punues i cili do të përgatis një plan veprimi për periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Formimi i këtij grupi duhet konsideruar si pikë fillestare në procesin e gjatë të avancimit të zhvillimit të Kuvendit. Grupi punues duhet të përgatis një plan të detajuar veprimi me një listë të qartë të synimeve të arritshme.

Duke pasur parasysh se gjatë vjeshtës, kur do të përgatitet buxheti për vitin 2009, është e rëndësishme që ta keni këtë plan veprimi të gatshëm ashtu që Kuvendi të mund të kërkojë fonde nga buxheti dhe nga donatorët ndërkombëtar.

Me përjashtim të përgatitjes së Rregullores së re të Punës, puna në draft-buxhetin e ri do të jetë një nga detyrat më të rëndësishme të Administratës dhe Kryesisë së Kuvendit. Gjatë këtij procesi, duhet pasur parasysh mundësitë ekzistuese financiare dhe raportin ndërmjet nevojës për të zbatuar projekte të caktuara dhe sigurimit të mjeteve të nevojshme financiare.

Kuvendi duhet të marrë përgjegjësinë për shpenzim racional të fondeve të siguruara nga Buxheti dhe donacionet ndërkombëtare dhe të sigurojë transparencë absolute gjatë shpenzimit të këtyre fondeve.

Kuvendi mund të llogarisë në mbështetjen e NDI-it dhe OSBE-së gjatë punës së tij në të ardhshmen kur fillojnë sfidat e reja për një mandat të ri.

SHTOJCA 1. LISTA E TAKIMEVE TË EKIPIT VLERËSUES

7.1. Vizita e parë në Kosovë (2 Qershor 2008 – 5 Qershor 2008)

2 Qershor

- 10.00 Seanca Plenare e Kuvendit
- 13.00 Anëtarët e Kryesisë
Xhezair Murati (7+) dhe Ibrahim Gashi (AKR)
- 14.00 Udhëheqësit e departamenteve administrative
Daut Beqiri, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe
Isa Neziri, Udhëheqës i Administratës)
- 16.30 Hydajet Hyseni (Anëtar i Kuvendit nga PDK-ja)

3 Qershor

- 09.00 Personeli i Komisionit për Buxhet dhe Financa
Natasha Prica (Koordinatore e Komisionit)
Arta Hajra (Këshilltare Ligjore e Komisionit)
- 10.00 Bahri Hyseni (Kryetar i Komisionit Legjislativ)
- 11.00 Mbledhja e Kryesisë së Kuvendit
- 12.00 Seanca Plenare e Kuvendit
- 15.00 Sali Rexhepi (Udhëheqës i Divizionit Procedural dhe Seanca Plenare)
Mikel Mirakaj (Nëpunës i Zyrës për Propozime dhe Parashtrës)
- 16.30 Flora Brovina (Kryetare e Grupit Parlamentar të Grave)

4 Qershor

- 09.00 Ibrahim Makolli (Shef i Grupit Parlamentar të AKR-së)
- 10.00 Zef Morina (deputet, ish Ministër i Transportit)
- 10.30 Ahmeti Isufi (AAK), Kryetar i Komisionit për Rregullore të Punës
- 11.30 Lutfi Haziri (Shef i Grupit Parlamentar të LDK-së)
- 12.00 Kryetari Jakup Krasniqi dhe kabineti i Kryetarit
- 13.00 Ramë Buja dhe Safete Hadergjonaj (Shefi dhe Zëvendës-shefja e Grupit Parlamentar të PDK-së)
- 14.00 Lulzim Zeneli Shef i Grupit Parlamentar të LDD-së
- 15.00 Seanca Plenare e Kuvendit
- 16.00 Ismet Krasniqi (Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit)

5 Qershor

- 09.00 Koordinatorët e Komisionit
Hasan Tahiri, Shpresa Haxhijaj dhe Minire Hasani
- 10.00 Xhavit Haliti (Anëtar i Kryesisë së Kuvendit)

- 11.00 Mbledhja e Komisionit për RReP
- 12.00 Sabiha Shala (Udhëheqëse e Agjencisë për Integritet Evropian)
- 14.00 Gani Koci (Kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa)
- 15.00 Ahmet Shala, Ministër i Ekonomisë dhe Financave
- 16.00 Shpresa Azemi Projekti i AER-it “Përkrahje Parlamentit”
- 17.00 Ismet Krasniqi (Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit)

6 Qershor

- 09.00 Arsim Bajrami (Ministër i Shërbimeve Publike)
- 09.30 Ekipi i OSBE-së për Monitorim të Kuvendit
- 10.15 Sabri Hamiti dhe Sllobodan Petroviç (anëtarë të Kryesisë së Kuvendit)
- 12.00 Kryetari Jakup Krasniqi dhe kabineti i Kryetarit

7.2. Vizita e 2-të në Kosovë (16 Korrik 2008 – 18 Korrik 2008)

17 Korrik

- 10.00 Paraqitja e draftit të 1^{er} të Raportit Vlerësues Udhëheqjes së Kuvendit (Kryetari, anëtarët e Kryesisë, shefat e grupeve parlamentare, kryetarët e komisioneve)
- 15.00 Ramë Manaj Zëvendës KM (Zyrtar për Ndërlidhje Kuvend - Qeveri)
- 16.00 Ismet Krasniqi (Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit)
Daut Beqiri, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe
Isa Neziri, Udhëheqës i Administratës

E premte, 18 Korrik

- 09.00 Biblioteka e Kuvendit
- 10.30 Komisioni për Rregulloren e Punës
- 11.30 Kryetari Jakup Krasniqi dhe kabineti i Kryetarit

SHTOJCA 2. BIBLIOGRAFI

Kuvendi i Kosovës “Rregullorja e Punës e Kuvendit të Kosovës”, e miratuar më 20 Maj 2005 dhe e amendamentuar më 1 Qershor 2006

Qendra për Demokraci dhe Qeverisje (2000) “Manual i USAID-it mbi Forcimin e Legjislativit”, Uashington DC

Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2006) “Raporti i Progresit mbi Kosovën 2006”, Bruksel

Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2006) “Raporti i Progresit mbi Kosovën 2006”, Bruksel

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në <http://ëëë.kushtetutakosoves.info>

DCAF (2003) “Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë – Parimet, Mekanizmat dhe Praktikrat”, Gjenevë

ECIKS (2008), “Udhëzues për Investitorë: Investimi në Kosovë 2008”, Iniciativa Ekonomike për Kosovën

“Përkrahje e Mëtejshme për Kuvendin e Kosovës” (2008), një projekt i BE-së i menaxhuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim

Grupi Ndërkombëtar i Krizave (2007), ‘Ndërprerja e rrugës qorre të Kosovës: Përgjegjësi e Evropës’, Raporti për Evropë numër 185, Bruksel

Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Dokumentim & Misioni i OSBE-së në Kosovë (2007) “Shoqëria Civile dhe Procesi Legjislativ në Kosovë – Studim Analitik në Fund të Mandatit të Dytë të Kuvendit të Kosovës”, Prishtinë

Instituti Kombëtar Demokratik për Çështje Ndërkombëtare – NDI (2007) “Broshurë mbi Mbikëqyrjen Parlamentare”, Prishtinë

Instituti Kombëtar Demokratik për Çështje Ndërkombëtare (2006) “Drejt Zhvillimit të Standardeve Ndërkombëtare për Legjislaturat Demokratike”, Uashington

Instituti Kombëtar Demokratik, Union Ndër-Parlamentar, Asociacioni Parlamentar i Komonueltit (2007) “Standardet Minimale Ndërkombëtare për Funkcionimin e Legjislaturave Demokratike”, Uashington DC

Misioni i OSBE-së në Kosovë (2008), “Monitorimi i punës së Kuvendit të Kosovës. Përpilimi i Raporteve të Monitorimit të Kuvendit 5 Gusht 2006 – 30 Nëntor 2007”, Prishtinë

Misioni i OSBE-së në Kosovë, Implementimi i Ligjeve të Kuvendit të Kosovës – raporti III. Periudha e shqyrtimit: ligjet e shpallura më 2005, 26 Janar 2007, f. 49

“Rregullorja mbi Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Kosovës”, Prishtinë, 2007

SIGMA (2006), ‘Kosovë: Shërbimi Publik dhe Korniza Administrative’, Raporti Vlerësues i SIGMA-s, Paris

Stapenhurst, Rick (2004) “Qeverisja e mirë, mbikëqyrja parlamentare dhe përgjegjësia financiare. Shqyrtimi Parlamentar i Buxhetit”, Instituti i Bankës Botërore

Taylor, Andrew J. (2005), “Kuvendi i Kosovës dhe Politika e Bashkëjetesës”. Revistë e studimeve Legjislative, Vëll.11, Numër1

“Rregullorja e punës së Parlamentit të Bosnjës”, Kolegjiumi i Zgjeruar i Kuvendit

Banka Botërore (2002), “Forcimi i mbikëqyrjes nga legjislaturat”, Shën. kryesore Numër 74

UNDP (2007), “Energji për Zhvillim – Raport për Zhvillimin Njerëzor në Kosovë 2007”, Prishtinë

Kombet e Bashkuara (2008), “Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë”, S/2008/211, Nju Jork

Kombet e Bashkuara (2008), “Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë”, S/2008/458, Nju Jork

Kombet e Bashkuara (2008), “Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë”, S/2008/354, Nju Jork

Van Meurs W., dhe Weiss S. (2003), ‘Evropa e Ardhme: Evropa Jug-Lindore pas Selanikut’, Qendra për Hulumtim të Politikave & Fondacioni Bertelsmann

Wehner,Joachim (2002) “Praktikat më të Mira të Komisioneve Për Mbikëqyrjen e Financave Publike”, Instituti për Demokraci në Afrikën Jugore, Praktikat më të Mira të Komisioneve për Llogaridhënie Publike, Kejptaun

www.assembly-kosova.org

www.ks-gov.net

www.unmikonline.org

SHTOJCA 3. ORANOGRAMI I ADMINISTRATËS SË KUVENDIT



